



Banka e Shqipërisë

2023

RAPORTI VJETOR  
I MBIKËQYRJES

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11

Faks: + 355 4 2419408


E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)




# P Ë R M B A J T J A

1.	<i>FUNKSIONI I MBIKËQYRJES</i>	7
2.	<i>ZHVILLIMET KRYESORE</i>	8
		11
3.	<i>EKZAMINIMET NË VEND</i>	12
4.	<i>KUADRI RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK</i>	15
5.	<i>LICENCIMI</i>	21
6	<i>ECURIA E RREZIQEVE NË SISTEMIN BANKAR DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA</i>	25
6.1	<i>Zhvillimet kryesore në ecurinë e sistemit bankar shqiptar</i>	25
6.2	<i>Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës</i>	26
6.3	<i>Struktura e sistemit bankar</i>	27
6.4	<i>Administrimi i rreziqeve në veprimtarinë bankare</i>	30
6.5	<i>Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit</i>	52
6.6	<i>Regjistri i Kredive</i>	60
	<b>ANEKSE</b>	62
1.1	<i>Struktura e Departamentit të Mbikëqyrjes</i>	62
1.2	<i>Pesha specifike e secilës bankë në sistemin bankar</i>	63
1.3	<i>Aktivët dhe pasivët</i>	64
1.4	<i>Treguesit financiarë bazë</i>	66
1.5	<i>Aksionerët e bankave</i>	67
1.6	<i>Të dhëna për aksionerët/ortakët e subjekteve financiare jobanka</i>	68
1.7	<i>Shpërndarja gjeografike e degëve dhe e agjencive bankare sipas prefekturave</i>	71
1.8	<i>Shpërndarja e produkteve/ shërbimeve të e-banking sipas bankave në fund të vitit 2023</i>	71
1.9	<i>Numri i subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve</i>	72
1.10	<i>Mbulimi me shërbime bankare deri në vitin 2023</i>	72
1.11	<i>Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2023</i>	73
1.12	<i>Lista e rregulloreve të mbikëqyrjes në fuqi deri më 31 dhjetor 2023</i>	74




## PËRMBAJTJA E TABELAVE

3	<i>Ekzaminimet në vend</i>	
Tabelë 1.	Numri i ekzaminimeve sipas tematikës për vitin 2023	12
5	<i>Licencimi</i>	
Tabelë 2.	Numri i agjentëve të institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, në fund të vitit 2023	24
6	<i>Ecuria e rreziqeve në sistemin bankar dhe institucionet financiare jobanka</i>	
Tabelë 3.	Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj PBB-së	27
Tabelë 4.	Ecuria e zërave kryesorë të aktiveve të sistemit bankar	28
Tabelë 5.	Ecuria e zërave kryesorë të pasiveve të sistemit bankar	28
Tabelë 6.	Ndryshimi me vitin paraardhës i zërave jashtë bilancit	29
Tabelë 7.	Indeksi H* (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë	29
Tabelë 8.	Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2023	30
Tabelë 9.	Kredia, sipas sektorit dhe qëllimit të përdorimit (vlera në miliardë lekë dhe pesha e secilit zë ndaj kredisë gjithsej)	31
Tabelë 10.	Struktura e tepricës së kredisë, sipas afatit (në përqindje)	31
Tabelë 11.	Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhës (në përqindje)	32
Tabelë 12.	Kredia sipas degëve të ekonomisë (në vlerë (miliardë lekë) dhe sipas peshës ndaj totalit të kredive)	33
Tabelë 13.	Pesha e tepricës së kredisë sipas klasave (në përqindje)	34
Tabelë 14.	Llojet e kolateraleve të shpërndara sipas sektorëve dhe monedhave (në përqindje)	36
Tabelë 15.	Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë (në përqindje; kumulative)	49
Tabelë 16.	Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore (në përqindje; kumulative)	49
Tabelë 17.	Treguesit mesatarë të përfitueshmërisë (në milionë lekë)	50
Tabelë 18.	Ecuria e treguesit të efikasitetit (në milionë lekë)	50
Tabelë 19.	Struktura e kapitalit aksioner të sistemit dhe ecuria e komponentëve të tij	51
Tabelë 20.	Veprimtaritë e lejuara për subjektet financiare jobanka	53
Tabelë 21.	Totali i aktiveve të IFJB-ve	54
Tabelë 22.	Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e SFJB-ve	55
Tabelë 23.	Ecuria e portofolit të kredisë bruto sipas veprimtarive të IFJB-ve	55
Tabelë 24.	Portofoli i qirasë financiare sipas objektit të financiar	56
Tabelë 25.	Volumet vjetore dhe teprica e portofolit faktoring	56
Tabelë 26.	Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë	57
Tabelë 27.	Totali i aktiveve të subjekteve IPE	57
Tabelë 28.	Ecuria e shërbimit të pagesave & transfertave (nuk përfshihet paraja elektronike)	58
Tabelë 29.	Volumi i të ardhurave	58
Tabelë 30.	Ecuria e aktiveve (në miliardë lekë)	59
Tabelë 31.	Ecuria e portofolit të kredisë bruto dhe neto për SHKK-të	60
Tabelë 32.	Institucionet e licencuara që raportojnë të dhëna në Regjistrin e Kredive	61



## PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE


<b>5</b>	<b>Licencimi</b>	
Grafik 1.	Struktura e sektorit bankar/financiar dhe pronësia	21
Grafik 2.	Ecuria e numrit të degëve/agjencive të bankave në vite	23
Grafik 3.	Shpërndarja gjeografike e popullsisë banuese dhe rrjetit të degëve/agjencive të bankave, sipas qarqeve, në vitin 2023 (në përqindje)	23
Grafik 4.	Ecuria e numrit të zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vite	23
<b>6</b>	<b>Ecuria e rreziqeve në sistemin bankar dhe institucionet financiare jobanka</b>	
Grafik 5.	Struktura e kapitalit në sistemin bankar, sipas origjinës, dhe ecuria e saj në kohë	26
Grafik 6.	Ecuria e rritjes mujore të kredisë gjatë vitit 2023 (në përqindje)	30
Grafik 7.	Teprica e kredisë akorduar biznesit dhe individëve ndaj tepricës totale të kredisë (në përqindje)	30
Grafik 8.	Vëllimi i tepricës së kredisë, sipas monedhave (në miliardë lekë)	32
Grafik 9.	Pesha e kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ndaj portofolit të kredisë në valutë (në përqindje)	32
Grafik 10.	Ecuria e portofolit të kredive me probleme dhe e portofolit të kredive, krahasuar me tremujorin paraardhës (në përqindje)	34
Grafik 11.	Ecuria e tepricës së kredisë me probleme në sistemin bankar	34
Grafik 12.	Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë me probleme	35
Grafik 13.	Ecuria e raportit kredi me probleme neto/kapital rregullator	35
Grafik 14.	Teprica e kredisë me probleme për bizneset dhe individët	35
Grafik 15.	Teprica e kredisë me probleme sipas monedhave	35
Grafik 16.	Ecuria 3-mujore e raportit "kredi me probleme në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit/ teprica e kredisë në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit"	36
Grafik 17.	Numri i ankesave të trajtuara në vite	48
Grafik 18.	Pesha e ankesave sipas segmentimit të ankuesve	48
Grafik 19.	Pesha e ankesave sipas segmentimit të produkteve të reklamuar	48
Grafik 20.	Pesha e ankesave sipas tipologjisë	48
Grafik 21.	Ecuria e kapitalit aksioner	51
Grafik 22.	Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe komponentëve të saj	51
Grafik 23.	Shpërndarja e aktiveve të IFJB-ve, dhjetor 2023	54
Grafik 24.	Shpërndarja e burimeve të financimit të IFJB-ve, dhjetor 2023	54





## 1. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES

Funksioni mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë (BSH) ka si objektiv kryesor identifikimin e hershëm të rreziqeve kryesore si: rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku operacional, rreziku i normës së interesit, rreziku i kapitalit dhe përfitueshmërisë, ai reputacional dhe i pastrimit të parave e financimit të terrorizmit, por jo vetëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe efektiviteti i qeverisjes korporative përbëjnë një fokus të veçantë si faktorë të rëndësishëm të zbutjes së rreziqeve në të gjithë sferën e veprimtarisë së bankave në veçanti, por edhe të subjekteve të tjera jobanka, të cilat licencohen nga BSH-ja. Veprimi në kohën e duhur dhe marrja e masave rregulluese efektive nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme - rrjedhojë e procesit të vlerësimit mbikëqyrës të bankave dhe më gjerë - si edhe zbatueshmëria e tyre, mbetet një nga hallkat e rëndësishme për të finalizuar me sukses qëllimin fundor, atë të ruajtjes së shëndetit të subjekteve financiare.



## 2. ZHVILLIMET KRYESORE

### ZHVILLIMET STRUKTURORE

Zhvillimi i veprimtarisë bankare gjatë vitit 2023 u karakterizua nga një rritje e portofolit të kredisë me 3.43%<sup>1</sup> dhe nga përmirësimi i cilësisë së tij, me një rënie të treguesit të kredive me probleme në 4.74% përkundrejt nivelit 5% në dhjetor 2022. Këto zhvillime mund të konsiderohen pozitive përkundrejt pritshmërive për rritjen e treguesit të kredive me probleme dhe një tkurrje të kërkesës për kredi, si pasojë e ndikimit nga rritja e normave të interesit që nga tremujori i fundit i vitit 2022. Treguesi i kredive me probleme pati tendencë rritëse gjatë vitit, ku nivelin më të lartë prej 5.3% e arriti në gusht 2023, periudhë nga e cila filloi rënia graduale e tij.

Bankat me kapital vendas fituan terren në veprimtarinë e tyre, duke e rritur peshën në totalin e aktiveve me rreth 1.8 p.p. Kjo tendencë evidentohet në strukturën e burimit kryesor të financimit, të depozitave, me rreth 1.17%, si dhe të portofolit të kredisë me rreth 1.26%. Këto zhvillime konfirmojnë pritshmërinë për një rritje të nivelit të ndërmjetësimit në financimin e ekonomisë së vendit.

### ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË VLERËSIMIT NGA KOMITETI MONEYVAL DHE I PLANIT TË VEPRIMIT TË ICRG/FATF

Një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit 2023 lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është **dalja e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si "lista gri" nga FATF në plenaren e datës 27 tetor 2023**. Ky vlerësim erdhi si rrjedhojë e angazhimit të shumë institucioneve në Shqipëri me reforma e politika të ndërmarra për përmbushjen e kriterëve të nevojshme, ku Banka e Shqipërisë ka dhënë kontributin e saj në kuadër të tagrave ligjore që mbulon. Banka e Shqipërisë ka kontribuar konsiderueshëm në të gjithë procesin e vlerësimit të Shqipërisë nga ekspertët e Komitetit të Moneyval – Rauti V i vlerësimit (2017-2018), dhe në mënyrë të veçantë në realizimin e detyrimeve që i lindnin Bankës së Shqipërisë nga plani i veprimit të ICRG/FATF për dhënie informacioneve dhe sqarimeve të nevojshme, nëpërmjet përfshirjes intensive në të gjitha takimet me ekspertët e ICRG/FATF-së.

<sup>1</sup> Në këtë përlogaritje është përjashtuar efekti i ndjeshëm i kursit të këmbimit, në prani të të cilit rritja e portofolit të kredisë do të ishte rreth 8%.





Dalja nga lista gri e FATF-së është një arritje e rëndësishme, pasi përbën një zhvillim pozitiv për vendin, ekonominë dhe reputacionin e tij. Ajo tregon se vendi është i përkushtuar për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe është një votëbesim nga komuniteti ndërkombëtar. Një nga përfitimet e mundshme nga dalja nga lista gri e FATF-së është rritja e investimeve dhe kosto më të ulëta për transaksionet financiare.

## VLERËSIMI I EKVIVALENCËS SË KUADRIT MBIKËQYRËS RREGULLATIV

Me heqjen e Shqipërisë nga lista gri e FATF-së është hapur rruga për rikthimin e diskutimit me Autoritetin Bankar Evropian (EBA) mbi procesin e vlerësimit të ekuivalencës. Në fillim të vitit 2022, EBA publikoi një metodologji të re vlerësimi. Sipas saj, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet asistencës teknike të Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD) dhe PricewaterhouseCoopers (PwC) Spanjë, ka kryer një vlerësim të pavarur të kuadrit mbikëqyrës aktual për bankat. Rezultatet e këtij vlerësimi treguan se kuadri rregullativ e procedural, si dhe praktikat mbikëqyrëse, qëndrojnë në një nivel të lartë ekuivalence dhe të përafuara me standardet e aplikueshme në vendet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në drejtim të kërkesave për kapital, teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, ekspozimeve të mëdha, likuiditetit, levës financiare, titullimit, mbikëqyrjes makroprudenciale, sekretit profesional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Pas paraqitjes së kërkesës zyrtare institucionit të EBA-s, pritet fillimi i diskutimeve mbi vlerësimin e ekuivalencës të Shqipërisë bazuar në metodologjinë aktuale nga mesi i vitit 2024.

## KONTRIBUTI NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

Gjatë vitit 2023, Departamenti i Mbikëqyrjes ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në kuadër të përgatitjes së prezantimeve dhe paraqitjes së tyre në Takimet Bilaterale në Bruksel, për disa kapituj të rëndësishëm për integrimin në BE, ku mund të përmenden: kapitulli 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit", kapitulli 9 "Shërbimet financiare", kapitulli 17 "Politikat ekonomike dhe monetare", kapitulli 20 "Ndërmarrjet dhe politikat industriale", kapitulli 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", kapitulli 28 "Mbrojtja e konsumatorit" dhe "Kriteri Ekonomik".

Në Takimet Bilaterale u prezantua niveli i përafritimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në kuadrin ligjor e rregullativ të Bankës së Shqipërisë, mangësitë e identifikuar dhe planet për përafritimin e mëtejshëm të këtij legjislacioni në të ardhmen.



## PËRGATITJA E UDHËZIMIT PËR RAPORTIMIN FINANCIAR

Si hap i rëndësishëm në zhvillimin e proceseve mbikëqyrëse, gjatë vitit, është hartuar drafti i dokumentit mbi raportimin financiar, i cili është hapi i parë i zbatimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të kontabilitetit. Ky dokument është hartuar duke u bazuar në standardet e përcaktuara nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA), si në përmbajtje dhe tabelat e raportit, ashtu edhe në udhëzimet shpjeguese. Dokumenti është shpërndarë tek bankat dhe ka shërbyer si pikënisje e dialogut mbi sfidat që e shoqërojnë procesin, duke përcaktuar edhe detyrimet që lindin për vënien në zbatim të tij. Me hartimin e tij janë evidentuar edhe rregulloret që duhet të rishikohen me qëllim që t'i përshtaten këtyre ndryshimeve, për të cilat do të punohet gjatë vitit 2024 e në vijim.

## HARTIMI I LIGJIT PËR LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE

Qëllimi i ligjit, i hartuar me asistencën e Bankës Botërore, është krijimi i kuadrit ligjor për të ofruar shërbimet e pagesave për të gjithë konsumatorët dhe veçanërisht, për individët që nuk zotërojnë llogari bankare, pa kosto ose me kosto të përballeshme prej tyre, duke garantuar dhe mundësuar të drejtën e çdo konsumatori, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit, historikut të aftësisë paguese, për të pasur akses në shërbimet bazë të llogarisë së pagesës.

Për këtë qëllim, ligji krijon kushte dhe rregulla për: a) mosdiskriminimin e konsumatorëve për hapjen e një llogarie pagese me shërbime bazike; b) detyrimin për bankat që të mos lejohen të refuzojnë hapjen e një llogarie bazike, përveç rasteve specifike të tilla si cenimi i kërkesave të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; c) mekanizmin e vendosjes së tarifave për llogarinë bazike, ku në përgjithësi parashikohet që tarifat për shërbimet e ofruara për llogarinë me shërbime bazike të jenë më të ulëta se ato për llogaritë standarde të pagesave, ndërsa për disa kategori vulnerabël është parashikuar që tarifa e ofrimit të shërbimeve të jetë zero.

## FINANCA E GJELBËR

Në kuadrin e financës së gjelbër dhe strategjisë së hartuar për përfshirjen e saj në proceset mbikëqyrëse, gjatë vitit 2023, është punuar për rritjen e njohurive mbi procese të ngjashme të ndërmarrë nga institucione homologe, si praktika më të mira ndërkombëtare, dhe për evidentimin e tipologjive të praktikave që mund të adoptohen në tregun vendas. Në të njëjtin drejtim është punuar me përfaqësues të Bankës Botërore, në rolin e konsulentit, për të zhvilluar procese dinamike për përfshirjen e këtij komponenti në identifikimin e



rreziqeve në ekspozimet ekzistuese, si dhe marrjen e masave për zbutjen e tyre në ekspozimet e ardhshme. Këto hapa janë ndërmarrë në përputhje edhe me iniciativat e parashikuara në strategjinë trevjeçare.

## RREZIKU KIBERNETIK

Kërcënimet ndaj sigurisë së informacionit kanë qenë kryefjala e zhvillimeve në dy vitet e fundit. Për shkak të zhvillimeve gjeopolitike në rrafsh global dhe qëndrimit aktiv të Republikës së Shqipërisë ndaj këtyre zhvillimeve, edhe përgjatë vitit 2023, sektorë kritikë, përfshi sistemin bankar dhe më gjerë atë financiar, kanë qenë nën kërcënime të vazhdueshme kibernetike të përshkallëzuara. Kjo situatë u shoqërua me rritjen e nivelit të alarmit dhe të masave shtrënguese në raport të drejtë me kërcënimet.

Sistemi financiar ka administruar në mënyrë të kujdesshme sulmet e vazhdueshme dhe të shumëllojshme nga aktorë keqdashës, të cilat kanë pasur si synim fundor më së shumti dëmtimin e imazhit dhe besimit të publikut te institucionet financiare dhe veçanërisht bankat, më shumë sesa për qëllime përfitimi të vlerave monetare. Për rrjedhojë, këto sulme nuk kanë arritur të përmbushin qëllimin e tyre. Gjatë vitit 2023 mund të veçojmë sulmet e mohimit të shërbimit (*DoS – Denial of Service*) të vërejtura gjatë tremujorit të tretë, të cilat kanë pasur në shënjestër edhe bankat e nivelit të dytë, me qëllim ndërprerjen e shërbimeve të ofruara nga faqet e tyre të internetit. Ndërsa në tremujorin e katërt të vitit 2023, kemi disa tentativa për *smishing* (impersonifikimin e faqeve zyrtare të bankave), të cilat kanë rezultuar gjithashtu të pasuksesshme falë masave të marra nga bankat, si dhe fushatave të ndryshme për ndërgjegjësimin e klientëve. Theksojmë se konstatohet një vëmendje e shtuar e klientëve në rastet e aksesimit në distancë të shërbimeve të bankës, ku vetë klientët e bankave identifikuan dhe raportuan disa tentativa për vjedhjen e kredencialeve të tyre.

Për sa më sipër, Banka e Shqipërisë ka forcuar shkallën e komunikimit dhe ndërveprimin veçanërisht me sektorin bankar dhe autoritetet rregulluese përgjegjëse të fushës, duke shtuar fokusin dhe vëmendjen në këtë drejtim, veçanërisht në procesin e inspektimeve në vend. Gjithashtu, për të pasur një panoramë të plotë dhe në të njëjtën kohë të sigurisë së sektorit bankar në lidhje me eficiencën dhe maturinë e tij në drejtim të parandalimit të materializimit të rrezikut kibernetik, u intensifikua për disa periudha marrja e një informacioni nga sektori bankar për këtë qëllim. Në këtë kontekst, me qëllim përditësimin e kuadrit rregullator me zhvillimet e sigurisë së informacionit dhe përmirësimin e pritshmërive mbikëqyrëse ndaj përgatitjes së sektorit financiar, Banka e Shqipërisë po vijon rishikimin e kuadrit rregullator sipas standardeve dhe praktikave më të mira të Bashkimit Evropian. Ky proces, në përputhje me qasjen e kahershme të Bankës së Shqipërisë, do të finalizohet edhe me bashkëveprimin e industrisë bankare me qëllim përfshirjen edhe të praktikave më të mira të tregut.



### 3. EKZAMINIMET NË VEND

Gjatë vitit 2023 janë kryer në total 8 ekzaminime në vend, konkretisht 4 ekzaminime të plota në banka, 3 ekzaminime të plota në institucione financiare jobanka dhe një ekzaminim i plotë në shoqëri kursim-krediti (SHKK).

Tabelë 1. Numri i ekzaminimeve sipas tematikës për vitin 2023

Inspektime të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku i Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfutshmëria	Kapitali
2021	7	7	12	7	7	7	8	8	109*	6	6
2022	8	9	12	12	8	8	8	8	82**	8	12
2023	8	8	8	8	4	8	7	7	61***	8	8

\* Në vitin 2021 janë kryer ekzaminime në 90 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 19 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka. Ndër këto, ekzaminimet për 2 banka, 6 institucione financiare jobanka dhe 1 zyrë këmbimi valutor, për këtë rrezik, janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.


\*\* Në vitin 2022 janë kryer ekzaminime në 70 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 12 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

\*\*\* Në vitin 2023 janë kryer ekzaminime në 50 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 11 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2023 janë kryer ekzaminime në dy banka sistemike dhe dy banka josistemike. Për bankat sistemike, fokusi kryesor ka qenë tek plotësimi i kërkesave rregullore për kapital, përfshirë edhe kërkesat për detyrime të pranuar dhe rezervat makroprudenciale. Bankat sistemike i nënshtrohen kërkesave shtesë për kapital në disa nivele, prandaj planifikimi dhe sigurimi i burimeve të nevojshme për plotësimin e këtyre kërkesave merr rol parësor në vlerësimin e përgjithshëm të tyre.

Krahas vlerësimit të kërkesave për kapital, rëndësi e përhershme i kushtohet edhe vlerësimit të sistemeve dhe kulturës së qeverisjes, administrimit të rreziqeve (të kredisë, likuiditetit, rreziqeve të tregut, atij operacional dhe reputacional), si dhe modelit të biznesit. Në përgjithësi, bankat sistemike kanë konsoliduar sistemet e administrimit të rreziqeve, por përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme në kuadër të shtimit të treguesve që monitorohen, harmonizimit të oreksit për rrezik me tolerancën ndaj rrezikut, parametrizimit të provave të rezistencës, etj.



Në lidhje me qeverisjen evidentohet se krahas përputhshmërisë me kërkesat ligjore e rregullative, bankat duhet të sigurojnë edhe një kulturë të qëndrueshme për një zbatim cilësor të parimeve “të një qeverisjeje të mirë”, që përfshijnë ndarjen e përshtatshme të detyrave dhe linjave të raportimit, sigurimin efektiv të pavarësisë për pozicionet kyç e të kontrollit, mbikëqyrjen efektive nga organet e larta drejtuese (këshilli drejtues, komiteti i kontrollit), etj.

Përsa i përket bankave josistemike, vëmendja mbikëqyrëse është përqendruar tek masat dhe sistemet për sigurimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat ligjore e rregullative, hartimin dhe ndjekjen e planeve strategjike të realizueshme në raport me kapacitetin rrezik-mbajtës të tyre, parakushtet e krijuara për të siguruar një rritje të shëndetshme të aktivitetit, etj. Ndër shqetësimet kryesore mbikëqyrëse për këtë kategori të bankave mbeten krijimi i një niveli të mjaftueshëm të fondeve rezervë për humbjet apo zhvlerësimin e aktiveve dhe reflektimi në kohë i tyre në pasqyrat financiare të bankës, si dhe planifikimi dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme të kapitalit për mbështetjen e aktivitetit (në kushtet kur një pjesë e mirë e tyre nuk i përkasin grupeve më të mëdha bankare).

Gjatë vitit 2023, ekzaminimet e subjekteve jobanka dhe SHKK-ve janë orientuar nga mbulimi i kategorive të ndryshme të veprimtarisë, ku përfshihen subjekte të pagesave, të kredidhënies, qirasë financiare dhe mikrokredisë. Në fokus kryesor të ekzaminimeve ka qenë modeli i biznesit, sistemet e qeverisjes, rreziku i kredisë, rreziqet e tregut dhe operacionale, saktësia e raportimeve në Bankën e Shqipërisë, transparenca me klientët dhe rreziku i pastrimit të parave. Nga ekzaminimet evidentohet se aktiviteti i këtyre subjekteve gjeneron të ardhura të qëndrueshme që kanë mbështetur kapitalin në vazhdimësi. Në përgjithësi, kadri i brendshëm organizativ dhe rregullativ përputhet me madhësinë dhe kompleksitetin e subjekteve që kanë pozicion të konsoliduar në treg, ndërsa tek subjektet më të reja evidentohen mangësi dhe nevoja për plotësime dhe përmirësime, në përputhje me nivelin aktual të veprimtarisë dhe parimet e një qeverisjeje të kujdesshme. Edhe në lidhje me saktësinë e raportimeve në Bankën e Shqipërisë, transparençën me klientët dhe parandalimin e pastrimit të parave, përputhshmëri e mirë evidentohet tek subjektet e konsoliduara në treg, ndërsa subjektet e tjera kanë shfaqur mangësi dhe shkelje të kërkesave ligjore dhe rregullative.

Ekzaminimet kanë evidentuar gjithashtu nevoja për përmirësim përsa i përket administrimit të përgjithshëm të rreziqeve financiare, rrezikut operacional dhe të TIK-së, sigurimit të burimeve njerëzore të mjaftueshme, etj.

Për shkeljet e evidentuara, Banka e Shqipërisë ka marrë masat përkatëse mbikëqyrëse, konkretisht, pezullimin e aktivitetit për një periudhë 6-mujore për një subjekt dhe lëshimin e urdhrat për ndërprerjen e shkeljeve dhe gjobitjen e administratorit për një subjekt tjetër.



Gjatë vitit 2023, janë kryer 3 publikime të NEIt maksimal, përfshirë edhe një publikim të ndërmjetëm, pas ndryshimeve rregullative që u realizuan në përgjigje të kërkesave të ardhura nga subjektet e sektorit të mikrofinancës.



## 4. KUADRI RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë vijoi punën për përafrimin e kuadrit ligjor e rregullativ me aktet përkatëse të Bashkimit Evropian, nëpërmjet hartimit të akteve të reja ligjore e nënligjore dhe rishikimit të kuadrit rregullativ në fuqi, për të mundësuar një mbikëqyrje sa më efektive për bankat dhe subjektet e tjera, të licencuara dhe mbikëqyrura prej saj.

Edhe gjatë vitit 2023, ka vazhduar puna për hartimin e kuadrit rregullativ, në zbatim të kërkesave të ligjit 55/2020 "Për shërbimet e pagesave", për ta plotësuar më tej këtë kuadër me kërkesa të reja, në përputhje me udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian (EBA) dhe akte të BE-së, të hartuara në zbatim të Direktivës së Shërbimeve të Pagesave (PSD2).

Në kuadër të përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023), më 14 dhjetor 2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike". Ky ligj, së bashku me rregulloren 59/2022 "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave", kanë transpozuar Direktivën 2014/92/EU (PAD) në kuadrin ligjor e rregullativ të Bankës së Shqipërisë, duke synuar përtej rritjes së transparencës dhe konkurrencës në treg, edhe nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë shqiptare. Transpozimi i Direktivës 2014/92/EU shënon edhe përmbushjen e detyrimeve të ndërrmarra nga Banka e Shqipërisë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025, në kuadër të angazhimeve të Kapitullit 9.

Gjithashtu gjatë vitit 2023, në Bankën e Shqipërisë u ngrit grupi i punës për hartimin e ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me pjesëmarrjen e ekspertëve nga departamente të ndryshme. Ligji i ri do të synojë përafrimin me kërkesat e Direktivës 2013/36/BE dhe me ndryshimet më të fundit të kësaj Direktive.

Pjesë e procesit të hartimit të akteve të reja ligjore e nënligjore, si dhe të ndryshimeve të kuadrit rregullativ në fuqi, kanë qenë edhe konsultimet me bankat apo subjektet e tjera, të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë, të cilat kontribuojnë me komentet dhe sugjerimet e tyre.

Në mënyrë më të detajuar, zhvillimet në kuadrin ligjor e rregullativ gjatë vitit 2023, paraqiten në vijim:

### I. Plotësimi i kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit 55/2020 "Për shërbimet e pagesave":



- **Miratimi i rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave” (miratuar me vendimin nr. 14, datë 23.3.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

Rregullorja përcakton kërkesat për mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së institucioneve të pagesave, duke parashikuar kërkesa të reja për këto institucione, në zbatim të dispozitave të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, si dhe duke rikonsideruar disa nga kërkesat në fuqi, të cilat kanë rregulluar deri më sot veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka, që ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave.

- **Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar” (miratuar me vendim nr. 48, datë 1.11.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

Këto ndryshime konsistojnë në rishikimin e kërkesave raportuese për disa subjekte të rregullores dhe përmbajnë përkatësisht: i) një sistem të ri raportues për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, të hartuar në përshtatje me kërkesat mbikëqyrëse që rrjedhin nga dispozitat e reja ligjore dhe kërkesat rregullative për këto subjekte; ii) disa ndryshime në format e raportimit për subjektet financiare jobanka, për të pasqyruar ndryshimet më të fundit rregullative për këto subjekte; iii) përfshirjen në sistemin elektronik të raportimit edhe të disa formularëve për bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit; iv) shtimin e një formulari për raportimin nga bankat të informacionit mbi transaksionet e pagesave sipas llojit të autentifikimit të përdorur, i cili synon të sigurojë statistika mbi zbatimin e kërkesave të rregullores “Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit”.





### HAPËSIRË INFORMUESE 1: RREGULLORJA E RE “PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE MBIKËQYRJEN E INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE”

Rregullorja parashikon kërkesa të reja rregullative për institucionet e pagesave, në zbatim të dispozitave të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

Kërkesat e reja, të parashikuara në rregullore, përfshijnë kërkesa mbi kapitalin rregullator dhe elementet e tij përbërës, metodën e llogaritjes së kërkesës për kapital rregullator, mbrojtjen e fondeve të klientëve, kontabilitetin dhe auditimin, etj.

Në rregullore prezantohen kërkesa më të kujdesshme referuar kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve që burojnë nga veprimtaria e institucioneve të pagesave, në kushtet kur këto institucione konsiderohen të rëndësishme meqenëse mbajnë fonde të klientëve për ofrimin e shërbimeve të pagesave. Për këtë arsye, kërkesat për kapital në këtë rregullore trajtohen në mënyrë të ngjashme me bankat, duke prezantuar për herë të parë konceptin e “kapitalit rregullator” dhe të “kërkesës për kapital rregullator”, në përputhje edhe me standardet e parashikuara në aktet përkatëse të BE-së, të transpozuar.

Rregullorja gjithashtu parashikon njehsimin e kërkesave për audituesin ligjor, ose shoqërinë e auditimit të institucioneve të pagesave, me kërkesat e parashikuara në ligjin dhe kuadrin nënligjor në fuqi për bankat, në përputhje edhe me kërkesat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe standardet e BE-së.

Kërkesat për mbrojtjen e fondeve të klientëve vijnë si kërkesa të reja për këto institucione, të përshtatura me kërkesat e reja të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, duke përcaktuar në rregullore llojet e aktiveve që do të konsiderohen si aktive të sigurta, me rrezik të ulët e likuide, për qëllime të përmbushjes së kërkesave ligjore e rregullative, për mbrojtjen e fondeve nga ana e institucioneve të pagesave.

Në mënyrë të detajuar, rregullorja parashikon kërkesa të reja përkatësisht për:

- elementet përbërëse të kapitalit rregullator, si dhe kufijtë rregullatorë për kapitalin bazë të nivelit të parë dhe kapitalin e nivelit të dytë, duke parashikuar trajtim të njëjtë me kërkesat e zbatueshme edhe për bankat, nëpërmjet referimit të kërkesave përkatëse të parashikuara në rregulloren “Për kapitalin rregullator të bankës”;
- metodën e llogaritjes së kërkesës për kapital rregullator të institucioneve të pagesave, në përputhje me metodën B të parashikuar në Direktivën 2015/2366/EU (PSD2), të përafëruar në ligjin “Për shërbimet e pagesave”;
- mbrojtjen e fondeve të klientëve të institucioneve të pagesave, duke parashikuar në plotësim të dispozitave të nenit 12 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, edhe llojet e aktiveve të sigurta, me rrezik të ulët e likuide;
- investimin e fondeve të klientëve në mënyrë të diversifikuar, në përmbushje të kërkesave për mbrojtjen e fondeve;
- kushtet që duhet të plotësojnë institucionet e pagesave për dhënien e kredive të lidhura me shërbimet e pagesave, të parashikuara në pikat 4 dhe 5 të aneksit 1 të ligjit 55/2020, si dhe kërkesën për kapital që këto institucione duhet të respektojnë në rastin kur japin kredi të tilla;
- raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e institucioneve të pagesave.



## II. Miratimi i ligjit nr. 100/2023 “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike” (miratuar më datë 14.12.2023 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë)

Miratimi i ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, së bashku me rregulloren 59/2022 “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave”, përmbushin transpozimin e Direktivës 2014/92/EU (PAD) dhe rregulloreve në zbatim të saj (rregulloreve 2018/32, 2018/33 dhe 2018/34 të BE-së), në kuadrin ligjor e rregullativ të Bankës së Shqipërisë, duke plotësuar angazhimet e Bankës së Shqipërisë në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025, për Kapitullin 9, por edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018-2023).

### HAPËSIRË INFORMUESE 2: LIGJI I RI “PËR LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE”

Ligji 100/2023 “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike” vjen si angazhim i Bankës së Shqipërisë në nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë dhe modernizimit të sistemit të pagesave, dhe si pjesë e masave të ndërmarra në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018-2023). Nëpërmjet zbatimit të kërkesave të ligjit, synohet rritja e numrit të llogarive bankare të pagesave, duke nxitur afrimin drejt sistemit bankar të shtresave të konsumatorëve, të cilët nuk kanë aktualisht një llogari bankare, si dhe përdorimin më aktiv të llogarive ekzistuese të pagesave për atë grup konsumatorësh, të cilët kanë një llogari por nuk e përdorin ose e përdorin minimalisht atë.

Ligji për llogarinë e pagesave me shërbime bazike ka në qendër të tij konsumatorin (klientin individ) dhe nuk zbatohet për llogaritë e pagesave të personave juridikë, mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla apo personave fizikë tregtarë. Ligji i ofron konsumatorit mundësinë për të pasur akses në shërbimet bazë bankare nëpërmjet llogarisë së pagesave me shërbime bazike, duke mos diskriminuar konsumatorët nisur nga statusi i punësimit apo gjendja e tyre financiare. Për të mundësuar këtë qëllim, ligji përcakton kushtet dhe rregullat për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me shërbime bazike. Ligji vendos detyrimin për bankat që të mos refuzojnë hapjen e një llogarie pagese me shërbime bazike, me përjashtim të rasteve specifike të tilla si cenimi i kërkesave të parandalimit të pastrimit të parave, si dhe disa kërkesa të tjera, me qëllim garantimin e shërbimeve bazë ndaj konsumatorëve. Gjithashtu, konsumatori ka të drejtën e ankimit pranë Bankës së Shqipërisë në rast refuzimi nga ana e bankave për hapjen e një llogarie të tillë.

Llogaria e pagesave me shërbime bazike është një llogari që ofron një grup shërbimesh bazike, të tilla si depozitime dhe/ose tërheqje fondesh, pagesa dhe transfertat të ndryshme në sportele, nëpërmjet kartave të debitit, apo platformave online, si dhe ofrohet vetëm në monedhën vendase (lekë) dhe shërben për ekzekutimin e transaksioneve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në shërbimet bazë që ofron kjo llogari, ligji përjashton transaksionet e pagesave me karta krediti, si dhe ofrimin e kredive të lidhura me shërbimet e pagesave.



*Konsumatorët do të përfitojnë këto shërbime bazë me tarifa më të favorshme se tarifat e aplikuar për llogaritë standarde të pagesave, ndërsa për disa kategori konsumatorësh është parashikuar që tarifa e ofrimit të shërbimeve të jetë zero.*

*Aktualisht, kategoritë e konsumatorëve që rregullohen nga ky ligj, përfitojnë kryesisht pagesa në cash, të tilla si pagesa e papunësisë, e ndihmës ekonomike, e paaftësisë ose e aftësisë së kufizuar, pensioneve, etj. Si rrjedhojë, çdo pagesë e kryer prej kësaj kategorie kryhet në cash, një instrument i kushtueshëm. Në këtë këndvështrim, ligji jo vetëm krijon akses në një llogari bankare, por mbështet edhe përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave, me ndikim në reduktimin e cash-it në ekonomi.*

*Për këtë qëllim, në ligj parashikohen kriteret, ku do të bazohen bankat, për përcaktimin e tarifës së arsyeshme, të zbatueshme për konsumatorët, si dhe parashikohet edhe grupi i konsumatorëve që përfitojnë nga programet dhe politikat për skemat e ndihmës ekonomike dhe sociale që do të përfitojnë të gjitha shërbimet e parashikuara në këtë ligj me tarifë zero. Në këto kategori janë përfshirë individët që përfitojnë nga mbrojtja dhe asistenca sociale, ekonomike dhe shëndetësore, si dhe pensionistët, studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.*

*Ligji përcakton mekanizmat e vendosjes së tarifave, sipas llojit të shërbimit të ofruar nga kjo llogari, si dhe modalitetet për transaksionet, si dhe parashikon kërkesa lidhur me trajtimin e ankesave dhe transparencës, si dhe kundërvajtjet administrative, sanksionet dhe të drejtën e procedurat për ankim.*

III. Në kuadër të rishikimit të kuadrit rregullativ, për implementimin e kërkesave të Bazel III dhe përafrimin me acquis të BE-së, përmenden zhvillimet e mëposhtme:

- Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar” (miratuar përkatësisht me vendimet nr. 36 dhe 37, datë 2.8.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

Ndryshimet konsistojnë në rishikimin e Aneksit 7 të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, përkatësisht të formularëve raportues të kërkesave për kapital (COREP) për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e tregut, si dhe të formularëve për ekspozimet në titullzime dhe të udhëzuesit metodologjik për plotësimin e tyre. Këto ndryshime janë reflektuar në të njëjtën mënyrë edhe në formularët e raportimit COREP mbi baza të konsoliduara, duke rishikuar Aneksin 3 të rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”.




#### IV. Zhvillime të tjera

- Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare” (miratuar me vendim nr. 9, datë 1.3.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

Ndryshimet e miratuara pasqyrojnë dinamikat e tregut mbi aplikimin e NEI-t maksimal për kredinë konsumatore dhe synojnë të sigurojnë një kalibrim më të saktë të përlogaritjes dhe përcaktimit të NEI-t maksimal.


- Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” (miratuar me vendim nr. 42, datë 6.9.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

Ndryshimet e rregullores parashikojnë një diferencim në trajtim për pagesat e kontributeve për anëtarësimin në SHKK (që janë në vlera tepër të ulëta), për të cilat nuk do të kërkohen disa dokumente të integritetit për anëtarët e rinj, ndërsa për çdo pagesë dhe/ose shtesë tjetër kapitali nën 100,000 lekë, parashikohet detyrimi i SHKK-së për të siguruar dhe mbajtur në dosje dokumentet e integritetit të anëtarëve/donatorëve.



## 5. LICENCIMI

Në fund të vitit 2023, struktura e sistemit bankar dhe financiar përbëhet nga 11 banka, 39 subjekte financiare jobanka, 621 zyra të këmbimit valutor, 16 shoqëri të kursim-kreditit dhe 1 union i shoqërive të kursim-kreditit.



Banka e Shqipërisë, bazuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ka autoritetin për të licencuar dhe mbikëqyrur bankat, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit e unionet e tyre, zyrat e këmbimit valutor dhe zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja.

### 1. Për bankat

Gjatë vitit 2023, në kuadër të përmbushjes së funksionit licencues, Banka e Shqipërisë ka marrë vendime që lidhen me:

- miratime të 66 administratorëve të bankave, ndër të cilët, sipas pozicioneve, renditen përkatësisht 23 anëtarë të këshillave drejtues, 15 anëtarë të komiteteve të kontrollit dhe 28 drejtues ekzekutivë dhe drejtues të kontrollit të brendshëm të bankave.
- miratimin e zgjerimit të rrjetit të bankave me 1 degë të re brenda



territorit të Republikës së Shqipërisë dhe 1 degë të re jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

- c) miratime të ndryshimeve në statutet e bankave, përkatësisht të Bankës ProCredit sh.a., të Bankës Credins sh.a. dhe të Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a.;
- d) miratime/moskundërshtime për emërimet/riemërimet e ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të fundvitit 2023 të të gjitha bankave;
- e) miratime për emetim të borxhit të varur nga Banka Credins sh.a. (3 raste), Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Tirana sh.a., Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., Banka Kombëtare Tregtare, Banka Union sh.a., si dhe shlyerjen e borxhit të varur nga Banka Credins sh.a.;
- f) miratimin për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë (ndërmjetës/agjent në sigurime) të 1 banke (OTP Bank Albania sh.a.).

## 2. Për subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike, gjatë vitit 2023, konsiston në:

- a) Licencimin e një institucioni të parasë elektronike (shoqëria "BKT Pay" sh.a.);
- b) licencimin e një subjekti financiar jobankë për ushtrimin e veprimtarisë "Blerja e kredive me probleme" (shoqëria "New Collection" sh.p.k.);
- c) miratime paraprake për emërimin / riemërimin e 9 administratorëve, 4 kryetarëve të këshillit mbikëqyrës dhe 1 kryetari të komitetit të kontrollit, të subjekteve financiare jobanka;
- d) miratime për transferimin e pjesëmarrjes influencuese të kapitalit të dy subjekteve financiare ("MIA Finance" sh.a. dhe "Landeslease" sh.a.);
- e) miratimin për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë (ndërmjetës/agjent në sigurime) të 1 institucioni të parasë elektronike ("lutePay" sh.p.k.);
- f) revokimin e licencës së një institucioni pagese me kërkesë të vetë subjektit ("Kastrati" sh.p.k.).

## 3. Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e shoqërive të kursim-kreditit

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmbushjes së funksionit licencues, për shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK) dhe unionet e shoqërive të kursim-kreditit, gjatë vitit 2023, konsiston në miratime për emërimin / riemërimin e 1 administratori të shoqërisë së kursim – kreditit.



#### 4. Për zyrat e këmbimit valutor

Vendimarrja e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmbushjes së funksionit licencues, për zyrat e këmbimit valutor, konsiston në:


- a) licencimin e 52 zyrave të reja të këmbimit valutor; dhe
- b) revokimin e licencës së 14 zyrave të këmbimit valutor, si masë mbikëqyrëse dhe për shkak të ndërprerjes së veprimtarisë.

#### 5. Të tjera

Në fund të vitit 2023, bankat e ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet 390 degëve/agjencie, të shtrira brenda territorit të vendit. Në grafikun në vijim, gjendet informacioni mbi numrin e degëve të bankave dhe tendencën e ndryshimit të tyre në vite.


Shpërndarja gjeografike e degëve/agjencie bankare përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit. Përqendrimi më i madh i degëve dhe agjencie bankare është në Tiranë (44.10%), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (33.50%). Po kështu, evidentohet që shpërndarja e degëve dhe agjencie bankare, sipas rajoneve, është në përpjesëtim me numrin e popullsisë.

Grafik 2. Ecuria e numrit të degëve/agjencie të bankave në vite




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Shpërndarja gjeografike e popullsisë banuese dhe rrejtit të degëve/agjencie të bankave, sipas qarqeve, në vitin 2023 (në përqindje)




Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Grafik 4. Ecuria e numrit të zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2023, vijuan aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor. Në fund të vitit, kjo veprimtari ushtrohet nga 621 zyra këmbimi valutor. Gjatë vitit u dhanë 52 licenca të reja të zyrave të këmbimit valutor, si dhe u revokuan 14 licenca.



Në zbatim të kërkesave të kuadrit rregullativ në fuqi, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike mund të ushtrjnë veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe/ose të shpërndarjes dhe të ripagimit të fondeve, në rastin e institucioneve të parasë elektronike, edhe nëpërmjet agjentëve, numri i të cilëve në fund të vitit 2023, është 1,569.

*Tabelë 2. Numri i agjentëve të institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, në fund të vitit 2023*

Subjekti	AK-INVEST	UNIONI FINANCIAR TIRANË	EASYPAY	RAEA FINANCIAR SERVICES	TOTALI
Agjentë të institucionit të pagesave	363			117	480
Agjentë të institucionit të parasë elektronike		617	472		1,089
TOTALI	363	617	472	117	1,569

*Burimi: Banka e Shqipërisë.*





## 6. ECURIA E RREZIQEVE NË SISTEMIN BANKAR DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA

### 6.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË ECURINË E SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR

Treguesi më i rëndësishëm i mbikëqyrjes, ai i mjaftueshmërisë së kapitalit, në fund të vitit 2023, raportohet në nivelin 19,4%<sup>2</sup>. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ky tregues shfaqet me një rënie prej 0.6 pikë përqindjeje.

Po kështu, edhe treguesi i kredive me probleme ka pësuar një rënie prej 0.25 p.p në terma vjetorë, duke arritur në 4.74% në fund të vitit 2023. Në fund të vitit 2023, kredia me probleme arriti nivelin 35 miliardë lekë, me një rënie prej 0.7 miliardë lekësh ose 1.95% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë, portofoli i kredive rezulton në rritje prej 24.5 miliardë lekësh ose rreth 3.43% gjatë këtij viti.


Treguesit e përfitueshmërisë - përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali aksioner mesatar (RoAE) - shfaqen në rritje krahasuar me vitin 2022. Vlerat, në fund të vitit 2023, shfaqen në 1.7% për RoAA dhe 17.3% për RoAE, ndërsa në fund të vitit 2022 këta tregues ishin përkatësisht 1.2% dhe 11.8%.

Zhvillimet kryesore të veprimtarisë bankare, gjatë vitit 2023, përmbledhen si më poshtë:

1. Treguesi i kredive me probleme ka pësuar një rënie prej 0.25 p.p në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 4.74 % në fund të vitit 2023;
2. Teprica e kredisë me probleme neto ndaj totalit të portofolit të kredisë neto paraqitet në nivelin 1.44%, në rënie me 0.4 p.p krahasuar me dhjetorin 2022;
3. Mbulimi me provigjione i kredive me probleme rezulton 70.56%, kundrejt nivelit prej 64.41% të një viti më parë;
4. Treguesit e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme paraqiten ndjeshëm mbi normat e parashikuara në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë. Në dhjetor 2023, raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra për sistemin bankar rezultoi 43.44%<sup>3</sup>, me një rritje prej 2.4 pikë

<sup>2</sup> Të dhënat e paraqitura në këtë raport për vitet e mëparshme mund të jenë të ndryshme nga ato të raportuara në raportet vjetor të mbikëqyrjes të vitit 2020, për shkak të korrjigimit të të dhënave të raportuara nga bankat dhe subjektet e tjera të licencuara si rezultat i proceseve audituese që sjellin saktësime të llogaritjeve.

<sup>3</sup> Niveli minimal i lejuar i këtij treguesi sipas kërkesave rregullative është 20%.




5. përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
5. raporti i mbulimit me likuiditetet rezulton në nivelin 303% përkundrejt limitit rregullator prej 100%;
6. në dhjetor 2023, vlera totale e depozitave të sistemit arrin në 1.605 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 5.7%, krahasuar me një vit më parë. Pesha e monedhës vendase në totalin e depozitave është rritur në 46.6%, nga 46.1% në dhjetor 2022;
7. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, si tregues thelbësor mbikëqyrës, në fund të vitit 2023, raportohet në nivelin 19.4%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ky tregues shfaqet me një rritje prej 0.6 pikë përqindjeje;
8. Rezultati financiar i vitit 2023 është pozitiv, me një vlerë prej rreth 32.5 miliardë lekësh, ose 11.7 miliardë lekë (56%) më i lartë se ai i vitit 2022.


## 6.2 STRUKTURA E KAPITALIT SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS

Kapitali aksioner i sistemit bankar arriti në vlerën 195.39 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 12.01 miliardë lekësh, ose 6.5% kundrejt një viti më parë. Struktura e kapitalit vijon të dominohet nga kapitali i huaj, i cili, në fund të vitit 2023, përfaqëson rreth 72.16% të kapitalit të paguar të sistemit bankar, me një rënie prej rreth 5 pikë përqindjeje kundrejt fundit të vitit 2022.

Grafik 5. Struktura e kapitalit në sistemin bankar, sipas origjinës, dhe ecuria e saj në kohë



Burimi: Banka e Shqipërisë



## 6.3 STRUKTURA E SISTEMIT BANKAR

### 6.3.1 AKTIVET DHE PASIVET, STRUKTURA E TYRE

Gjatë vitit 2023, aktivet e sistemit bankar shënuan një rritje prej rreth 89.43 miliardë lekësh ose 4.77%, përkundrejt rritjes me 104.02 miliardë lekë ose 5.87% të një viti më parë. Portofoli i kredive ka pasur rritje me 24.5 miliardë lekë ose 3.43%, gjatë këtij viti.

Pesha që zë sistemi bankar në ekonomi, e shprehur nëpërmjet raportit të totalit të aktiveve ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), vijon të qëndrojë në nivele të larta, por treguesi këtë vit vjen në rënie me 2.9 p.p. duke shkuar në nivelin 84.98%. Ndërkohë edhe raporti i kredive ndaj Produktit të Brendshëm Bruto ka pësuar rënie me 1.52 p.p, si pasojë e rritjes më të madhe të PBB-së kundrejt rritjes së portofolit të kredive.


Tabelë 3. Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj PBB-së

Treguesit	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Totali i aktiveve (në mld lekë)	1,453.45	1,475.55	1,580.82	1,773.29	1,875.84	1,965.28
Totali i aktiveve/PBB (në %)	88.80	87.21	95.96	95.53	87.88	84.98
Totali i kredive/PBB (në %)	35.48	34.03	36.96	36.15	33.50	31.98

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e aktiveve të sistemit bankar, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shfaq këto zhvillime kryesore:

- rënie të veprimeve me thesarin dhe ndërbankare me 8.1 miliardë lekë ose 1.6%, e cila buron kryesisht nga rënia e marrëdhënieve me bankat dhe institucionet financiare me 28 mld lekë, ose 15.6%, ndërkohë që me rritje paraqiten marrëdhëniet me bankën qendrore me 10.8 mld lekë ose 5.1%, portofoli i bonove të thesarit me një rritje 4.3 mld lekë ose 4.3%.
- rritje të veprimeve me klientët (neto) me 22.8 miliardë lekë ose me 3.3%;
- rritje të veprimeve me letrat me vlerë (neto) me 70.5 miliardë lekë ose me 11.5%;
- rritje të mjeteve të tjera me 2 miliardë lekë ose me 9.3%;
- rritje të mjeteve të qëndrueshme me 2.2 miliardë lekë ose me 8.2%.



Tabelë 4. Ecuria e zërave kryesorë të aktiveve të sistemit bankar

Treguesit:	Dhjetor 2022			Dhjetor 2023		
	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi % ***	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi % ***
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	519.9	27.7	5.43	511.8	26.0	(1.56)
Nga të cilat:						
- Mjete monetare	27.3	1.5	(6.87)	31.9	1.6	17.15
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	213.0	11.4	14.05	223.8	11.4	5.07
- Bono thesari	100.1	5.3	37.09	104.4	5.3	4.26
- Marrëdhënie me bankat e tjera	179.6	9.6	(11.97)	151.6	7.7	(15.57)
2. Veprime me klientët (neto)	692.0	36.9	(30.63)	714.8	36.4	3.29
3. Veprimet me letrat me vlerë (neto)	615.5	32.8	5.76	686.0	34.9	11.46
4. Mjete të tjera	21.4	1.3	(10.19)	23.4	1.2	9.28
5. Mjete të qëndrueshme	27.1	1.4	8.12	29.3	1.5	8.17
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>1,875.8</b>	<b>100.0</b>	<b>5.78</b>	<b>1,965.3</b>	<b>100.0</b>	<b>4.77</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zërat 1, 2, 3 të tabelës së mësipërme përfshijnë dhe interesat e përllogaritura.

\* në miliardë lekë

\*\* në % ndaj totalit të aktivitetit

\*\*\* në % ndaj një viti më parë

Struktura e detyrimeve të sistemit bankar, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shfaq këto zhvillime kryesore:

- rritje me 86.94 miliardë lekë ose 5.73% të zërit “Veprime me klientët”. Kjo rritje është përcaktuar nga:
  - rritja e zërit “sektori privat” me 81.26 miliardë lekë ose 5.45%, nga ku ndikimin kryesor e ka sjellë rritja e depozitave me afat me 45.5 mld lekë ose 7.26% dhe rritja e llogarive rrjedhëse me 42.7 mld lekë ose 6.62%.
  - rritje të burimeve të përhershme me 17.6 miliardë lekë ose 8.34%;
  - rënie të detyrimeve të tjera me 5.2 miliardë lekë ose 17.7%;
  - rënie të veprimeve me thesarin dhe ndërbankare me 14.1 miliardë lekë (12.28%);
  - rritje të veprimeve me letra me vlerë prej 134.8%, por pesha e tyre mbetet e vogël.

Tabelë 5. Ecuria e zërave kryesorë të pasiveve të sistemit bankar


Treguesit:	Dhjetor 2022			Dhjetor 2023		
	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi %***	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi %***
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	114.5	6.1	1.5	100.4	5.1	(12.28)
2. Veprime me klientët	1,518.2	80.9	5.9	1,605.2	81.7	5.73
3. Veprime me letrat me vlerë	3.1	0.2	0.3	7.3	0.4	134.78
4. Detyrime të tjera	29.3	1.6	19.1	24.1	1.2	(17.77)
5. Burime të përhershme	210.7	11.2	5.6	228.2	11.6	8.34
<b>Totali i pasivit</b>	<b>1,875.8</b>	<b>100.0</b>	<b>5.8</b>	<b>1,965.3</b>	<b>100.0</b>	<b>4.77</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

\* në miliardë lekë

\*\* në % ndaj totalit të pasivit

\*\*\* në % ndaj një viti më parë



Gjatë vitit 2023, pesha e zërave jashtë bilancit ndaj aktiveve totale të sistemit ka pësuar rënie, duke arritur në nivelin 95.73%, nga 105.25% që ishte në fundin e vitit 2022. Zërat jashtë bilancit kanë pësuar rënie si në vlerë ashtu dhe si peshë ndaj totalit të aktiveve. Siç ilustron në Tabelën 6, gjatë këtij viti, rënia vjetore ka ardhur si pasojë e rënies së angazhimeve të marra dhe angazhimeve të dhëna. Në strukturën e zërave jashtë bilancit, angazhimet e marra janë elementi më i rëndësishëm, me një peshë prej 90.63% nga 87.13% që ishte në fund të vitit 2022.

Tabelë 6. Ndryshimi me vitin paraardhës i zërave jashtë bilancit

Treguesit:	Ndryshimi me vitin paraardhës		Dhjetor 2022	Ndryshimi me vitin paraardhës		Dhjetor 2023
	Dhjetor 2022			Dhjetor 2023		
	Në mld lekë	Në %		Në mld lekë	Në %	
TOTALI	585.2	25.3	1,974.3	(93.0)	(4.7)	1,881.3
Angazhime të dhëna	(52.9)	(26.3)	148.3	(10.8)	(7.3)	137.4
Nga të cilat:						
- Angazhime financimi	9.2	14.7	72.0	10.0	13.9	81.9
- Garanci	7.3	17.9	48.3	(2.0)	(4.1)	46.3
- Angazhime për letrat me vlerë	(69.4)	(71.2)	28.0	(18.9)	(67.4)	9.1
Angazhime të marra	(342.2)	(16.6)	1,720.2	(15.2)	(0.9)	1,705.0
Nga të cilat:						
- Angazhime finacimi	1.1	28.9	4.9	11.8	243.4	16.7
- Garanci	(348.0)	(17.0)	1,703.2	(22.8)	(1.3)	1,680.4
Transaksione në valutë	30.6	152.6	50.7	(30.0)	(59.1)	20.7
Angazhime të tjera	(0.1)	(2.1)	2.6	(0.1)	(5.6)	2.4
Angazhime për instrumente financiare	22.4	74.0	52.6	(36.9)	(70.1)	15.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 6.3.2 PËRQENDRIMI


Treguesit e përqendrimit, të shprehur nëpërmjet indeksit Herfindahl të përlogaritur për totalin e depozitave dhe indeksin e kredisë paraqiten pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2022, ndërsa për totalin e aktiveve paraqitet në rënie me 0.01 p.p. Megjithatë të tre treguesit paraqiten në nivele të ulëta.

Tabelë 7. Indeksi H\* (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë

Treguesit	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Indeksi H (aktivet)*	0.16	0.15	0.15	0.14	0.15	0.14
Indeksi H (depozita)	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15
Indeksi H (kredia)	0.13	0.12	0.12	0.12	0.13	0.13

Burimi: Banka e Shqipërisë.

\* Vlerat e këtij treguesi luhaten në shifrat 0 deri në 1, ku vlerat më afër 0 përfaqësojnë nivele të ulëta përqendrimi.



## 6.4 ADMINISTRIMI I RREZIQEVE NË VEPRIMTARINË BANKARE

### 6.4.1 RREZIKU I KREDISË

#### 6.4.1.1 Aktiviteti kreditues


Gjatë vitit 2023, totali i kredisë pësoi një rritje prej 24.5 miliardë lekësh ose rreth 3.43%.

Tabelë 8. Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2023

Treguesit	2018	2019	2020	2021
Indeksi H (aktivet)*	0.16	0.15	0.15	0.14


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Ecuria e rritjes mujore të kredisë gjatë vitit 2023 (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7. Teprica e kredisë akorduar biznesit dhe individëve ndaj tepricës totale të kredisë (në përqindje)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e parë evidentohet një rënie e portofolit të kredisë me 2.5 mld lekë ose 0.36%, ndërkohë që tremujorët e tjerë evidentojnë rritje të portofolit të kredisë. Në tremujorin e dytë rritja ka qenë modeste me vetëm 0.38 mld lekë ose 0.05%. Ndërkohë që tremujori i tretë dhe i katërt kanë pasur një rritje më të madhe me përkatësisht 11.4 mld lekë ose 1.6% dhe 15.2 mld lekë dhe 2.11%. Ndërsa përsa i përket rritjes mujore, në muajt gusht dhe dhjetor 2023 është evidentuar rritja më e madhe e portofolit të kredisë me përkatësisht 21 mld lekë ose 3%, dhe 19.7 mld lekë ose 2.75 %. E mesatarizuar, rritja mujore ka qenë 0.29%.

Analiza e kredisë sipas **llojit të subjektit** evidenton një përqendrim më të lartë në sektorin privat, rreth 60.8%, në rënie 0.7 p.p, ndërkohë kreditimet për këtë sektor gjatë vitit 2022 janë rritur me 9.8 miliardë lekë (2.24%). Edhe kredia për individë rezulton në rritje me 23 miliardë lekë (9.22%) duke kontribuar në një rritje të peshës së saj me 2 p.p. Kredia dhënë sektorit publik ka regjistruar një rënie me 8.4 miliardë lekë (33%).

Analiza sipas **subjektit dhe qëllimit të përdorimit**<sup>4</sup> të kredisë evidenton se kredia “hua për blerje banesash” për individët zë peshën më të madhe ndaj totalit të portofolit të kredisë (26%), pasuar nga “hua për pasuri të paluajtshme” nga biznesi me 23.3%, kredia për “overdraft” dhënë bizneseve (14.6%), “dhe kredia për “blerje pajisjesh” me 11.2%.

4 Të dhënat nuk përfshijnë jorezidentët.



Rritjen më të lartë gjatë vitit 2023 e shfaq kredia dhënë biznesit për "pasuri të paluajtshme" me 43.5%, e pasuar nga kredia dhënë individëve për "mallra jo të qëndrueshme" me 15%, si dhe kredia dhënë individëve "për overdraft" me 13%.

Tabelë 9. Kredia, sipas sektorit dhe qëllimit të përdorimit (vlera në miliardë lekë dhe pesha e secilit zë ndaj kredisë gjithsej)

PËRSHKRIMI	Dhjetor 2022	Pesha në %	Ndryshimi në % Dhjetor 2022 - Dhjetor 2021	Dhjetor 2023	Pesha në %	Ndryshimi në % Dhjetor 2023 - Dhjetor 2022
Kredia gjithsej	661.1	100.0	7.1	693.7	100.0	4.9
Kredia dhënë biznesit	411.9	62.3	4.4	422.0	60.8	2.5
Overdraft	102.2	15.5	13.0	101.4	14.6	(0.8)
Kapital qarkullues	75.7	11.4	2.5	73.2	10.6	(3.2)
Hua për çelje biznesi	9.3	1.4	(5.7)	8.0	1.2	(13.6)
Blerje pajisjesh	111.8	16.9	2.4	77.5	11.2	(30.7)
Pasuri të paluajtshme	112.4	17.0	0.9	161.3	23.3	43.5
Hua për investime në instrumeta financiare	0.5	0.1	4.0	0.6	0.1	4.2
Kredia dhënë individëve	249.2	37.7	11.8	271.7	39.2	9.0
Overdraft	8.0	1.2	5.8	9.0	1.3	12.9
Mallra jo të qëndrueshëm	36.6	5.5	9.1	42.1	6.1	15.0
Mallra të qëndrueshëm	24.6	3.7	6.0	25.5	3.7	3.7
Hua për blerje banesash	166.7	25.2	14.2	180.7	26.0	8.4
Hua për qëllime të tjera	13.3	2.0	6.2	14.4	2.1	8.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Të dhënat e tabelës së mësipërme i referohen vetëm klientëve rezidentë, jopublikë dhe në to nuk përfshihen interesat e përlogaritura.

Struktura e kredisë **sipas afatit**, ka pasur disa ndryshime në strukturë, pasi vërehet një rënie e peshës së kredive afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata. Rënien më të madhe në vlerë e ka pasur kredia afatgjatë me 28 mld lekë ose 10.46%, pasuar nga kredia afatshkurtër me 12 mld lekë ose 7.74%.


Tabelë 10. Struktura e tepricës së kredisë, sipas afatit (në përqindje)

Afati i maturimit	Dhjetor 2022	Mars 2023	Qershor 2023	Shtator 2023	Dhjetor 2023
Afatshkurtër	22.8	22.0	22.3	21.6	20.3
Afatmesme	13.2	13.1	13.4	12.9	12.9
Afatgjatë	37.5	37.9	37.7	36.1	32.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Grafik 8. Vëllimi i tepricës së kredisë, sipas monedhave (në miliardë lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Portofoli i kredive sipas monedhës, për vitin 2023, në ndryshim nga viti 2022, evidenton se kredia në lekë ka peshën më të madhe në totalin e kredisë me 53.7% dhe me një rritje me 4 p.p. Ndërkohë që pesha e portofolit të kredisë në valutë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë evidenton një rënie krahasuar me vitin 2022 me 4 p.p.

Tabelë 11. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhës (në përqindje)

Monedha	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Lekë	49.7	48.9	48.6	53.7
Valutë	50.3	51.1	51.4	46.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9. Pësja e kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ndaj portofolit të kredisë në valutë (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2023, pesha e kredisë në valutë, e klasifikuar si e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, ndaj totalit të portofolit në valutë<sup>5</sup>, në krahasim me vitin paraardhës, ka shfaqur një rënie me 0.39 p.p, duke arritur në nivelin 28%.

Struktura e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë<sup>6</sup>, për vitin 2023, evidenton kreditim më të madh të bizneseve kundrejt individëve. Sektorët më të kredituar të ekonomisë vazhdojnë të mbeten "Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave" me një peshë prej 30.3% të portofolit, pasuar nga sektori i "Ndërtimit" me një peshë prej 17.3% dhe sektori i "Industrisë përpunuese" me një peshë prej 12.4%.

<sup>5</sup> Përcaktimi për kreditë e pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit jepet në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, nr. 62, datë 14.9.2011, "Për administrimin e rrezikut të kredisë", neni 4, pika 2, shkronja "c".

<sup>6</sup> Të dhënat nuk përfshijnë jorezidentët.





Tabelë 12. Kredia sipas degëve të ekonomisë (në vlerë (miliardë lekë) dhe sipas peshës ndaj totalit të kredive)

Përshkrimi	Dhjetor 2022		Dhjetor 2023	
	Në vlerë	Pesha në %	Në vlerë	Pesha në %
<b>Bizneset</b>	411.9	62.3	422.0	60.8
Bujqësia, Pyjet, Peshkimi	6.9	1.7	6.8	1.6
Industria nxjerrëse	6.1	1.5	5.1	1.2
Industria përpunuese	51.9	12.6	52.5	12.4
Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	32.8	8.0	33.7	8.0
Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1.5	0.4	1.2	0.3
Ndërtimi	72.7	17.6	72.8	17.3
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	136.5	33.1	127.9	30.3
Transporti dhe magazinimi	10.6	2.6	16.1	3.8
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	33.5	8.1	37.5	8.9
Informacioni dhe komunikacioni	7.0	1.7	6.1	1.5
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	3.5	0.8	4.7	1.1
Aktivitete të pasurive të paluajtëshme	7.9	1.9	13.3	3.2
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2.4	0.6	1.9	0.5
Shërbime administrative dhe mbështetëse	3.3	0.8	3.5	0.8
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	0.1	0.0	0.1	0.0
Arsimi	6.1	1.5	4.6	1.1
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	5.4	1.3	6.8	1.6
Arte, argëtim dhe çlodhje	0.6	0.1	0.7	0.2
Aktivitete të tjera shërbimi	23.0	5.6	25.0	5.9
Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet	0.0	0.0	1.3	0.3
Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	0.0	0.0	0.1	0.0
<b>Individët</b>	249.2	37.7	271.7	39.2
<b>Totali</b>	661.1	100.0	693.7	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Të dhënat e tabelës i referohen vetëm klientëve rezidentë dhe në to nuk përfshihen interesat e përlogaritura.

#### 6.4.1.2 Cilësia e Aktiveve

Në fund të vitit 2023, kredia me probleme arriti nivelin 35 miliardë lekë, duke u ulur me 0.7 miliardë lekë ose 1.95% krahasuar me një vit më parë. Treguesi i kredive me probleme bruto ka pësuar një rënie prej 0.26 p.p në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 4.74% në fund të vitit 2023.



Grafik 10. Ecuria e portofolit të kredive me probleme dhe e portofolit të kredive, krahasuar me tremujorin paraardhës (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Ecuria e tepricës së kredisë me probleme në sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Teprica e kredisë me probleme neto ndaj totalit të portofolit të kredisë neto paraqitet në nivelin 1.44 %, në rënie me 0.4 p.p krahasuar me dhjetorin 2022.


Në portofolin e kredive të rregullta, evidentohet rritje e kredive të klasifikuara “standard” me 0.8 pikë përqindje. Ndërkohë, në portofolin e kredive me probleme, evidentohet ulje e klasave të kredive të klasifikuara “nënstandard” dhe “të dyshimta” me përkatësisht 0.2 p.p dhe 0.4 p.p, ndërsa kreditë e humbura evidentojnë një rritje me 0.4 p.p.

Tabelë 13. Pësia e tepricës së kredisë sipas klasave (në përqindje)


Klasifikimi i kredisë	2022				2023			
	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV
Standard	91.2	91.6	92.0	91.3	91.3	91.7	91.2	92.1
Në ndjekje	3.7	3.2	3.0	3.8	3.7	3.3	3.6	3.3
Nënstandard	1.5	1.8	1.6	1.5	1.5	1.6	1.7	1.3
Të dyshimta	1.1	0.9	1.0	1.1	1.3	1.1	0.7	0.7
Të humbura	2.6	2.4	2.4	2.2	2.3	2.4	2.8	2.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë rezultojnë në 24.7 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 1.7 miliardë lekësh ose 7.48% kundrejt një viti më parë; ndërsa mbulimi i kredive me probleme me fonde rezervë për humbjet nga kreditë është 70.56%, rreth 6.16 pikë përqindje më i lartë në harkun kohor të një viti.



Grafik 12. Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Treguesi i kredive me probleme neto ndaj kapitalit rregullator ka rënë me 1.58 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë, si rezultat i rënies së kredive me probleme neto me 2.4 miliardë lekë ose 18.98%, ndërkohë që kapitali rregullator është rritur me 7.5 miliardë lekë ose 4.19%.

Për sa i përket cilësisë së kredisë të ndarë sipas llojit të subjektit, treguesi i kredisë me probleme për biznesin ka rënë me 0.2 p.p, duke shkuar në nivelin e 5.7%, ndërkohë që edhe për individët ka rënë me 0.4 pikë përqindje kundrejt një viti më parë, duke shënuar nivelin 3.4%.

Për sa i përket ndarjes së kredive me probleme sipas monedhës, rezulton se treguesi i kredive me probleme në valutë nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin e kaluar dhe ka mbetur në nivelin 4%, ndërkohë që treguesi i kredive me probleme në lekë evidenton një rënie me 0.6 p.p., duke arritur në nivelin 5.4% kundrejt 6% në fund të vitit të kaluar.


Treguesi i kredive me probleme të kredive në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është në nivelin 4.07%, në ulje me vetëm 0.09 p.p kundrejt fundit të vitit 2022. Kjo ulje ka ardhur si pasojë e rënies së kredive me probleme në valutë të pambuluara nga rreziku i kursit të këmbimit me 9.97 % dhe rënies së tepricës së kredive në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit me 8.04%.

Grafik 13. Ecuria e raportit kredi me probleme neto/kapital rregullator




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Teprica e kredisë me probleme për bizneset dhe individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 15. Teprica e kredisë me probleme sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Grafik 16. Ecuria 3-mujore e raportit "kredi me probleme në valutë e pamblujtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit/ teprica e kredisë në valutë e pamblujtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit"



Nga të dhënat e raportuara, rezulton se pjesa më e madhe e portofolit të kredive (75%) është e kolateralizuar, duke u ulur në peshë me 11 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (86%). Referuar llojit të kolateralit, pjesa më madhe e kredive të sistemit, rreth 44%, është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme. Kreditë për individët në valutë kanë një nivel më të lartë mbulimi me kolateral me pasuri të paluajtshme me 70% krahasuar me kreditë për bizneset me 36%.

Tabelë 14. Llojet e kolateraleve të shpërndara sipas sektorëve dhe monedhave (në përqindje)


Llojet e kolateralit	Dhjetor 2023					
	Individë		Biznes		Total	
	lekë	valutë	lekë	valutë	lekë	valutë
Pasuri të paluajtshme	51%	70%	37%	36%	44%	44%
Cash	1%	4%	1%	2%	1%	2%
Kolateral tjetër	13%	15%	42%	36%	28%	31%
Kredi e pakolateralizuar	35%	11%	20%	26%	27%	23%
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë kryen edhe analizat e provës së rezistencës (stress-test) për të matur qëndrueshmërinë e kapitalit të bankës në përballimin e rreziqeve të veprimtarisë bankare. Këto analiza tregojnë se niveli aktual i kapitalit të sistemit bankar është i mjaftueshëm për të përballuar një nivel relativisht të lartë të humbjeve që vijnë si rezultat i ekspozimeve ndaj rrezikut të kredisë. Kjo aftësi e kapitalit për të përballuar humbjet e mundshme ka qenë konstante përgjatë gjithë vitit 2023.

### 6.4.2 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Situata e përgjithshme e likuiditetit të sistemit bankar, gjatë vitit 2023, ka vijuar të provojë qëndrueshmëri, duke paraqitur një ekspozim relativisht të ulët ndaj rrezikut të likuiditetit. Rritja e qëndrueshme e nivelit të depozitave, si kontribuues kryesor i financimit të aktivitetit të bankave, niveli dy herë më i lartë i treguesit të likuiditetit kundrejt minimumit rregullator (i llogaritur si raport i aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra), niveli i ulët i treguesit "kredi ndaj depozitave", si dhe aftësia e sistemit për të gjeneruar likuiditet në rastet e materializimit të situatave të jashtëzakonshme, përbëjnë një kuadër të kënaqshëm për mbrojtjen ndaj rrezikut të likuiditetit.



Treguesit e likuiditetit, në mënyrë të vazhdueshme, paraqiten ndjeshëm mbi normat e parashikuara në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë. Në dhjetor 2023, raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra për sistemin bankar rezultoi 43.44%, me një rritje prej 2.4 pikë përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja rrjedh si pasojë e ritmit të ndryshëm të lëvizjes në aktive likuide e pasive afatshkurtra. Aktivet likuide kanë njohur rritje me 9%, ndërkohë që pasivet afatshkurtra janë rritur me 3.1%. Lëvizjet kryesore në aktivet likuide rezultojnë në rritjen e llogarive me Bankën e Shqipërisë duke përfshirë rezervën e detyruar deri në masën e përdorimit të saj, si dhe orientimin drejt investimeve të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe në investimet e letrave me vlerë të huaja, të cilat plotësojnë kushtet për t'u konsideruar aktive likuide sipas rregullores nr. 71 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", neni 19. Rritja më e lartë vjen nga aktivet në valutë, rrjedhojë e rritjes së normave bazë të interesit e më tej, në valutat kryesore si EUR dhe USD.

Treguesi i likuiditetit në valutë, në dhjetor 2023, paraqitet në nivelin 30.6%<sup>8</sup> (nga 27.11% që ishte në dhjetor 2022), rezultat i rritjes së aktiveve likuide në valutë në nivel më të lartë kundrejt rritjes së lehtë të pasiveve afatshkurtra po në valutë. Reflektimi i menjëhershëm në kahun e aktiveve i ndryshimit të normave të interesit në valutë ka ndikuar në rritjen e investimeve në aktive likuide, duke e konsideruar si një mundësi përfitimi njëkohësisht edhe prudence në aspektin e rrezikut të likuiditetit. Në krahun e pasiveve, reflektimi më i ulët i ndryshimit të normave të interesit, njëkohësisht edhe ndryshimet në kursin e këmbimit, me vlerësimin e monedhës Lek, përcillen me një rritje më të ulët në valutë të depozitave të klientëve. Lëvizjet e aktiveve likuide në valutë janë kryesisht në investimet në letra me vlerë të qeverive e bankave qendrore të huaja, në institucione financiare me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare dhe emetime nga banka ndërkombëtare të zhvillimit. Njëkohësisht rritje kanë njohur llogaritë me Bankën e Shqipërisë duke përfshirë rezervën e detyruar deri në masën e përdorimit të saj. Aktivet likuide në lekë vijojnë të mbeten mbështetësit kryesorë të likuiditetit në nivelin 61.7% të totalit të aktiveve likuide (58.8% të totalit të aktiveve likuide, dhjetor 2022).

Raporti i Mbulimit me Likuiditet (RML)<sup>9</sup> raportohet në nivelin 303%, i përcaktuar kryesisht nga treguesi në lekë. I ndarë në monedhën vendase dhe monedhë të huaj, treguesi në lekë është 343%, ndjeshëm më i lartë se ai i monedhave të huaja të rëndësishme që raportohet në nivelin 214%. Kjo vjen si rezultat i strukturës së aktiveve likuide, të cilat dominohen nga letrat me vlerë në lekë të Qeverisë Shqiptare.

<sup>7</sup> Niveli minimal i lejuar i këtij treguesi sipas kërkesave rregullative është 20%.

<sup>8</sup> Niveli minimal i lejuar i treguesit në lekë, sipas kërkesave rregullative është 15%, ndërsa i atij në valutë është 20%.

<sup>9</sup> Raporti i mbulimit me likuiditet matet si raport midis rezervës së likuiditetit (ose aktiveve likuide) me flukset dalëse neto. Flukset dalëse neto llogariten si ndryshimi midis flukseve hyrëse me flukset dalëse, me kusht që flukset hyrëse të jenë më pak se 75% e flukseve dalëse. Nëse flukset hyrëse janë më të larta se 75% e flukseve dalëse, atëherë zbatohet taveni i flukseve hyrëse, pra jo më shumë se 75%. Kufizimet minimale rregullatore të RML-së janë 100% për totalin e të gjitha monedhave dhe 80% për monedhat e huaja të rëndësishme.



Raporti Neto i Financimit të Qëndrueshëm të Bankave (RNFQ)<sup>10</sup> përgjatë vitit 2023 ka rezultuar mbi limitet rregullative për sistemin, si në total ashtu edhe për valutë. Rregullorja për bankat josistemike ka të përcaktuar llogaritjen e thjeshtuar të këtij treguesi, ndërkohë bankat sistemike duhet të përdorin llogaritjen e caktuar në rregullore. Rrjedhimisht kemi raportimet me llogaritjen bazë dhe ato me llogaritjen e thjeshtuar. Raporti RNFQ në total për dhjetor 2023 për bankat sistemike dhe ato që kanë zgjedhur llogaritjen bazë raportohet në nivelin 172%, në monedhën vendase në nivelin 175% dhe në valutë 167%. Raporti RNFQ me mënyrën e thjeshtuar të llogaritjes në total është në nivelin 163%, në monedhën vendase 202% dhe në valutë raportohet në nivelin 141%.

### 6.4.2.1 Depozitat e sistemit<sup>11</sup>

Depozitat e klientëve mbeten burimi kryesor i financimit për sistemin bankar shqiptar, me një peshë prej 81.7% (80.9% në dhjetor 2022) të totalit të pasivitet. Në dhjetor 2023, vlera totale e depozitave të sistemit arrin në 1.605 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 5.7%, krahasuar me një vit më parë. Peshë e monedhës vendase në totalin e depozitave është rritur në 46.6%, nga 46.1% në dhjetor 2022. Struktura e maturitetit përgjatë vitit 2023 reflekton një rritje më të lartë në depozita me afat, pasuar nga llogaritë rrjedhëse, ndërkohë që depozitat pa afat kanë njohur një rënie të lehtë. Struktura e depozitave, si një normalitet i njohur, peshon në afatet më të shkurtra. Viti 2023 ka njohur një zhvendosje në drejtim të afateve më të gjata.

### 6.4.2.2 Përqendrimi i depozitave

Lidhur me përqendrimet e depozituesve më të mëdhenj, në dhjetor 2023, dhjetë depozituesit më të mëdhenj zënë 8.04% të totalit të depozitave të sistemit bankar, kundrejt 6.9% që zinin në dhjetor 2022. E njëjta ecuri me rritje progresive vërehet edhe për grupet e tjera të depozituesve të mëdhenj<sup>12</sup>.

Depozitat e individëve mbeten baza kryesore e depozitave të sistemit, me një peshë prej 77.6% të totalit të depozitave, por me rënie rreth 1.9 pikë

<sup>10</sup> Treguesi për herë të parë zyrtarisht është raportuar në mars 2023, pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2023, të rregullores nr. 70 "Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave", miratuar më 2 dhjetor 2020 e ndryshuar me vendim nr.45, datë 1 shtator 2021. Ky tregues matet si raport midis financimit të qëndrueshëm të disponueshëm me financimin e qëndrueshëm të kërkuar. Financimet e qëndrueshme të disponueshme llogariten duke shumëzuar vlerën kontabël të detyrimeve dhe zërave të kapitalit me faktorët e financimit të disponueshëm në përputhje me rregulloren. Ngjashmërisht financimi i qëndrueshëm i kërkuar llogaritet duke shumëzuar vlerën kontabël të zërave të aktiveve me faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me rregulloren. Kufizimet minimale rregullatore të RFQN-së janë 100% për totalin e të gjitha monedhave dhe 70% për monedhat e huaja të rëndësishme, ku më 1 janar 2025, ky kufizim do të jetë 100%.

<sup>11</sup> Me termin "depozita" i referohemi të gjitha burimeve nga klientët, përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat, depozitat pa afat dhe llogaritë e tjera të tyre, përveç kur specifikohet ndryshe.

<sup>12</sup> 20 depozituesit e mëdhenj: 10.5% në 2023, kundrejt 9.1% në 2022. 50 depozituesit e mëdhenj: 13.6% në 2023, kundrejt 12.3% në 2021.



përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Gjatë këtij viti, ritmet më të larta në rritje i ka pasur sektori publik e sektori privat (përkatësisht 21.1% dhe 14.4%), ndërsa sektori individ ka njohur një rritje me 3.2%.

#### 6.4.2.3 Treguesi “kredi ndaj depozitave”

Raporti kredi/depozita, në dhjetor 2023, paraqitet në nivelin 46.07% (dhjetor 2022: 47.09%) dhe reflekton një strukturë të aktiv-pasiveve që krijon lehtësi në administrimin e likuiditetit, si dhe stimuj potencialë në kredidhënie. Gjatë vitit 2023, treguesi është ngushtuar lehtësisht, për shkak të ritmeve të ndryshme të ecurisë së portofolit të kredisë dhe totalit të depozitave (ku portofoli i kredisë ka njohur rritje më të ulët, kundrejt rritjes së depozitave). Raporti midis monedhës vendase dhe monedhave të huaja, gjatë këtij viti është i lartë në monedhën vendase në nivelin 53%, ndërsa valuta në nivelin 40%. Treguesi në valutë ka njohur tkurrje kundrejt një periudhe më parë (valuta: 39.97% nga 44.89%).

#### 6.4.2.4 Aktivet likuide të sistemit

Aktivitetet likuide janë rritur me 50 miliardë lekë ose 9%, gjatë vitit 2023. Rritja vjen më së shumti nga investimet në valutë, por dhe monedha vendase ka pasur rritjen e saj. Portofoli i investimeve në letra me vlerë vijon të përbëjë peshën më të madhe të aktiveve likuide. Investimet në llogaritë bankare apo të institucioneve financiare në formën e llogarive rrjedhëse, depozitave apo huave kanë njohur rënie. Kjo sjellje përkon me arsyetimin e mundësive për kthime më të mira në instrumente borxhi likuide.


Totali i aktiveve likuide të sistemit bankar, në dhjetor 2023, arriti në 605 miliardë lekë, dhe në strukturën e tyre, peshën kryesore e zënë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare (me 51.9% nga 52.1% në dhjetor 2022).

#### 6.4.2.5 Burimet e tjera financiare

Burimet e tjera financiare të sistemit bankar kanë një peshë relativisht të vogël në totalin e pasiveve, rreth 5.1%, me një tkurrje të lehtë gjatë vitit (dhjetor 2022: 6.06%). Pjesa kryesore e këtij zëri përfaqësohet nga detyrimet ndaj institucioneve financiare dhe marrëveshjet e riblerjes.

#### 6.4.2.6 Provat e rezistencës

Provat e rezistencës, si rezultat i aplikimit të skenarëve të ndryshëm me ngjarje të paparashikuara dhe faktorë që mund të ndikojnë negativisht në likuiditet, kanë treguar se të gjitha bankat mund të përballojnë me sukses situata të tilla.



### 6.4.3 RREZIQET E TREGUT

Situata e përgjithshme e ekspozimit të sistemit bankar ndaj rreziqeve të tregut, edhe gjatë vitit 2023, ka qëndruar relativisht në nivele të ulëta. Në vlerësimin e rreziqeve të tregut në librin e tregtueshëm dhe në librin e bankës janë përfshirë treguesit (faktorët e rrezikut) e ekspozimit ndaj: ndryshimit të normës së interesit në librin e bankës; rrezikut të kursit të këmbimit në të gjithë bilancin; rrezikut të pozicionit (në mënyrë specifike, ndryshimit të normave të interesit në portofolin e tregtueshëm dhe të vendosjes jorezident), si dhe aftësisë mbrojtëse të kapitalit për mbulimin e humbjeve të mundshme nga këto rreziqe.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut në nivel sistemi përbën vetëm 1.46% të të gjithë kërkesës për kapital. Ky ekspozim vjen ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Rreziku i tregut me burim ekspozimin ndaj normës së interesit (matur si ndryshimi i vlerës së ekspozimit në librin e bankës, pas goditjes standarde të normës së interesit, kundrejt kapitalit rregullator), gjatë vitit, reflekton rrezik mesatarisht të ulët të strukturës së ricimitit të aktiveve dhe pasiveve të sistemit bankar. Vlera e këtij treguesi, në dhjetor 2023, është 5.27%, krahasuar me 6.32% në dhjetor 2022<sup>13</sup>. Diferencë nga mesatarja paraqesin banka të veçanta, si pasojë e ndryshimeve të maturitetit mesatar të portofolit të kredisë dhe investimeve në letra me vlerë, të cilat megjithatë mbeten brenda limiteve dhe larg kufijve rregullatorë.

Rreziku i tregut me burim ekspozimin nga kursi i këmbimit, i vlerësuar nga dinamika e pozicionit të hapur valutor, vijon të shfaqet i ulët, dhe kjo sjellje ka qenë mbizotëruese gjatë gjithë periudhës vjetore. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në dhjetor 2023, ishte “në blerje” në masën 11.44 miliardë lekë, ose 6.1% e kapitalit rregullator të sistemit bankar<sup>14</sup>, nivele këto larg limitit rregullator.

Rreziku i tregut në portofolin e tregtueshëm për sistemin bankar është shumë i vogël. Ky rrezik vlerësohet i tillë përgjatë gjithë ecurisë vjetore të analizuar. Portofoli i tregtueshëm në nivel sistemi shfaqet mjaft i ulët ndaj totalit të aktiveve (0.14% në dhjetor 2023, nga 0.08% që ishte në dhjetor 2022). Rreziku i tregut me burim normën e interesit në portofolin jorezident të vendosjes dhe të tregtueshëm (portofoli jorezident i vendosjes mbar faktorë të rrezikut të tregut) vlerësohet në nivele të ulëta kundrejt totalit të aktiveve.

Provat e rezistencës për rrezikun e kursit të këmbimit, duke përdorur skenarë të ndryshëm të goditjes (ndryshimit) së kursit të këmbimit, tregojnë se si bankat individuale, ashtu edhe sistemi bankar në tërësi, do të ishin në gjendje të përballonin skenarët e parashikuar.

<sup>13</sup> Niveli maksimal i lejuar i këtij treguesi, sipas kërkesave rregullative, është 20%.

<sup>14</sup> Niveli maksimal i lejuar i këtij treguesi, sipas kërkesave rregullative, është 30%.





#### 6.4.4 RREZIKU OPERACIONAL

Humbjet e sistemit bankar nga rreziku operacional shfaqen në rritje krahasuar me vitin e mëparshëm. Në vitin 2023 janë raportuar 500 milionë lekë humbje vjetore bruto, ndaj 193 milionë lekë në vitin 2022. Rritje të humbjeve kanë raportuar 8 banka njëra prej të cilave ka raportuar rreth 41% të humbjeve të sistemit, 2 banka kanë raportuar rënie në nivelin e humbjeve dhe vetëm një bankë nuk ka raportuar humbje.

Raporti i humbjeve ndaj kërkesës për kapital paraqet përkeqësim nga viti i kaluar, duke shënuar rritje nga 2.31% në vitin 2022, në 5.18% në vitin 2023, si pasojë e rritjes së humbjeve operationale nga viti i kaluar me 160%, ndërkohë që edhe kërkesa për kapital ka ardhur në rritje me 16%.


##### 6.4.4.1 Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit

Ndryshimet e vazhdueshme në industrinë e teknologjisë së informacionit, si dhe rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me problematikat e ndryshme që rrjedhin nga përdorimi i saj, veçanërisht në lidhje me sigurinë kibernetike dhe atë të informacionit, kanë ndikuar në shtimin e vëmendjes dhe investimeve nga ana e bankave. Vëmendje e veçantë po i kushtohet rritjes së sigurisë së informacionit dhe monitorimit të vazhdueshëm të rrezikut në lidhje me të. Gjatë vitit 2023, një peshë të madhe të këtyre investimeve kanë zënë ato për sigurinë kibernetike, në përgjigje të situatës gjeopolitike në të cilën ndodhet Shqipëria. Një ndikim të rëndësishëm në rishikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit ka pasur miratimi i rregullores për autentifikimin e thelluar të klientit, e cila vendos kërkesa specifike lidhur me sigurinë e transaksioneve të kryera në rrugë elektronike në distancë.

Kuadri i politikave dhe procedurave në lidhje me TIK-në ka ardhur duke u pasuruar në vijimësi, por për shkak të spektrit të gjerë të aktiviteteve që mbulon, si dhe zhvillimeve dinamike në fushën e teknologjisë, plotësimi dhe përmirësimi i tij mbetet një proces i vazhdueshëm.

#### 6.4.5 RREZIKU REPUTACIONAL

Rreziku reputacional, si një nga rreziqet që mund të dëmtojë bankat dhe institucionet financiare në mënyrë të menjëhershme, ka si element kryesor vlerësimi, dyshimet e mundshme për përfshirje apo përdorim të institucioneve financiare për qëllime të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, mungesën e transparencës në marrëdhëniet me klientët, mosrespektimin e kushteve të punës e termave të kontratave etj.



#### 6.4.5.1 Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

Gjatë vitit 2023 janë konstatuar përpjekje pozitive të bankave dhe subjekteve financiare në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PPP/PFT). Përgjithësisht, nga inspektimet në vend të kryera në banka gjatë vitit 2023 ka rezultuar se, për çështjet e administrimit të rrezikut PPP/FT, bankat i kushtojnë vëmendje dhe kanë rritur përpjekjet për një administrim të përshtatshëm të këtij rreziku, respektimin e kërkesave ligjore, rregullatore dhe të kuadrit të brendshëm rregullativ në këtë fushë. Problematikat e evidentuara i përkasin tipologjive të tilla si: kuadri rregullator, proceset e vigjilencës së duhur/zgjeruar, mbështetja në palë të treta. Veçanërisht bankat, kanë ngritur struktura dhe sisteme të kënaqshme për këtë funksion dhe kanë rritur efikasitetin e masave parandaluese, çka reflektohet në rritjen e numrit dhe cilësisë së raporteve të aktiviteteve të dyshimta.

Në mbikëqyrjen e këtij rreziku, Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar ngushtë edhe me autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF), nëpërmjet kryerjes së inspektimeve të përbashkëta, shkëmbimit të informacionit, koordinimit të raportimeve për organizmat ndërkombëtare, trajnimeve, etj. Bashkëpunimi ka vijuar edhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme nëpërmjet shpërndarjes tek subjektet e licencuara të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave për vendosjen e sanksioneve dhe përditësimin e listës së financuesve të terrorizmit dhe të sanksioneve ndërkombëtare.

Fokusi mbikëqyrës edhe këtë vit është vënë kryesisht në fusha të tilla si:

- politikat dhe procedurat;
- strukturat dhe sistemet e centralizuara;
- identifikimi i pronarit përfitues dhe strukturës së pronësisë së kontrollit të klientit;
- cilësia e raporteve të aktivitetit të dyshimtë (RAD) dhe analiza e transaksioneve komplekse e të pazakonta që janë kryer apo tentohen të kryhen;
- kategorizimi i klientëve dhe transaksioneve sipas shkallës së rrezikut;
- zbatimi i detyrimeve ligjore;
- sistemet e kontrollit të brendshëm;
- administrimi efektiv i rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave/financimi i terrorizmit.

Konkretisht, gjatë vitit 2023, janë kryer inspektime për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në 61 subjekte, nga këto:

- o 5 banka
- o 5 subjekte financiare jobanka
- o 1 shoqëri kursim-krediti (SHKK)
- o 50 ZKV, prej të cilave në 11 ZKV është realizuar ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për mangësitë e konstatuara në ekzaminimin e mëparshëm.



Nga këto, në kuadër të bashkëpunimit për çështjet e PPP/PFT, referuar inspektimeve në vend si më lart, vlen të përmendet se janë kryer dy inspektime të përbashkëta me Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF) në dy banka.

Llojet e problematikave të identifikuara në **banka** i përkasin tipologjive të tilla si: kuadri rregullator, proceset e vigjilencës së duhur/zgjeruar, trajnimet, stafi dhe sistemi i centralizuar, që në mënyrë të përmbledhur paraqiten më poshtë:

- nuk shprehet qartë në procedurë se kush është personi përgjegjës për çështjet e PPP/PFT në bankë;
- dokumenti “Manuali i Parandalimit të Pastrimit të Parave” dhe “Njihni klientin tuaj”, si dhe përkrahjet e punës të punonjësve për periudhën që inspektohet nuk janë përditësuar në linjë me ndryshimet e ndodhura në strukturën organizative të bankës;
- raste të cilat rezultojnë me indicie dhe nuk janë raportuar RAD;
- mangësi në përditësimin e informacionit të klientëve;
- transaksione në para fizike në vlera të larta;
- përdorimi i llogarive personale për qëllime biznesi;
- mbështetja vetëm në ekstraktin e biznesit, pa analizuar të dhënat financiare të subjektit (aktivitetit) kundrejt profilit të klientit;
- mangësi në proceset e automatizuara;
- raste të transaksioneve në para fizike mbi pragun prej një milion lekësh që nuk ishin raportuar RTPF pranë AIF;
- mungesë të një sistemi të dedikuar për çështjet e PPP-ve;
- në sistemin e bankës nuk janë parashikuar skenarë në lidhje me kartat e kreditit;
- pozicioni i personit përgjegjës rezulton të jetë në kushtet e konfliktit të interesit për çështjet e PPP/PFT-ve;
- mosplotësim me staf në njësinë e parandalimit të pastrimit të parave;
- trajnimet për stafin e bankës janë me frekuencë të ulët, jo në përputhje me kërkesat ligjore/rregullore;
- nuk janë zhvilluar trajnime specifike për stafin e drejtorisë së përgjithshme veçanërisht të departamenteve që impaktohen nga detyrimet ligjore për PPP/PFT-të, të tilla si ai i operacioneve, kartave, pagesave, kredia, etj.;
- në trajnimet e zhvilluara nuk ka testim të stafit mbi njohuritë e përfituara në trajnime;
- në trajnimet orientuese të zhvilluara nuk kanë marrë pjesë të gjithë punonjësit e rinj.

Në lidhje me çështjet e administrimit të rrezikut të financimit të terrorizmit dhe zbatimit të sanksioneve nuk janë konstatuar problematika.

**Për institucionet financiare jobanka (IFJB) dhe shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK)**, nga inspektimi i tyre janë evidentuar mangësi në kuadrin e brendshëm rregullator për PPP/FT; strukturën/stafin përgjegjës; zbatimin e vigjilencës së duhur dhe zgjeruar; sistemin e centralizuar; kontrollin e brendshëm; proceset e administrimit të rrezikut TF dhe TFS; trajnimet; etj.



Për mangësitë e evidentuara janë lënë rekomandimet përkatëse me qëllim adresimin në kohë të tyre. Llojet e problematikave të identifikuara në institucionet financiare jobanka (IFJB) dhe në shoqëritë e kursim-kreditit, në mënyrë të përmbledhur, kanë konsistuar kryesisht në:

- Kuadrin e brendshëm rregullator:
  - kuadri rregullator jo në përputhje me kërkesat ligjore/rregullatore në fuqi;
  - mangësi në kuadrin rregullator në lidhje me masat kundër financimit të terrorizmit dhe zbatimit të sanksioneve.
  
- Mangësi në kryerjen e vigjilencës së duhur:
  - mungesë të procesit të filtrimit/verifikimit të klientëve me listat e shpallura dhe sanksionet;
  - nuk është kryer dhe dokumentuar vlerësimi i rrezikut, përfshirë dhe rrezikun që rrjedh nga ekspozimi ndaj financimit të terrorizmit;
  - mosnjohim i Bankës së Shqipërisë mbi personin përgjegjës;
  - raportim në Bankën e Shqipërisë jo në përputhje me kërkesat rregullatore;
  - mungesë të analizave mbi profilin e klientit;
  - mungesë të evidencave për verifikimet e kryera kundrejt listave të shpallura;
  - mosraportim në Bankën e Shqipërisë të dhëna sipas kërkesave rregullatore;
  - procesi i vlerësimit të rrezikut PPP/FT nuk ka të përcaktuar shkallën e ekspozimit të subjektit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - në sistem mungon informacioni në lidhje me nivelin e rrezikut të anëtarit (SHKK);
  - sistemi i subjektit nuk mundëson verifikimin e klientëve me listat e shpallura.
  
- Trajnimet:
  - mungesë trajnimesh për personin përgjegjës;
  - materialet e trajnimeve nuk janë të plota pasi nuk kanë përfshirë çështjet që lidhen me FT dhe TFS.
  
- Mangësi të tjera:
  - Mungesë adresimi të rekomandimit të mëparshëm në lidhje me përditësimin e dokumentacionit të klientit.
  
- Administrimi i rrezikut FT dhe sanksioneve:
  - mungesë të kryerjes së procesit të filtrimit/verifikimit të klientëve me listat e shpallura dhe sanksioneve;
  - mungesë të evidencave për verifikimet e kryera kundrejt listave të shpallura;
  - mungesë në kryerjen dhe dokumentimin e vlerësimit të rrezikut që rrjedh nga ekspozimi ndaj financimit të terrorizmit;



- mungesë auditimi për çështjet e FT-ve përfshirë dhe ato të PPP-ve;
- mungesë trajnimesh për çështjet e FT/TFS. Në raste kur trajnimet janë kryer evidentohet që materialet e trajnimit nuk janë të zgjeruara në drejtim edhe të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare.

Nga inspektimi i **Zyrave të Këmbimit Valutor (ZKV)** janë evidentuar mangësi në lidhje me mungesën e njohurive dhe për pasojë moszbatimin e detyrimeve ligjore/rregullore në lidhje me: (i) zbatimin e vigjilencës së duhur/zgjeruar; (ii) sistemin e centralizuar; (iii) trajnimet; (iv) mungesë evidencash që dokumentojnë verifikimin në lidhje me TF dhe TFS; (v) mungesë analizash dhe mungesë shfrytëzimi të portalit të raportimit online të AIF-së. Për adresimin e mangësive, përpos rekomandimeve, ndaj tyre janë marrë edhe masa administrative (gjoba).

Për problematikat e evidentuara për ZKV-të është vijuar me masa mbikëqyrëse/administrative përkatësisht si më poshtë:

- Masë administrative 17 ZKV
- Tërheqje vëmendje 8 ZKV
- Revokim licence 2 ZKV

Llojet e problematikave të identifikuar në ZKV kanë konsistuar kryesisht në:

- mungesë të një rregulloreje të brendshme në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PPP/PFT), kur aktiviteti ushtrohet nga jo më pak se tre persona;
- mosrespektim i procedurave identifikuese të klientëve në drejtim të identifikimit të klientëve dhe verifikimit të identitetit të tyre, si dhe mangësi në ruajtjen e dokumentacionit mbështetës të veprimeve valutore;
- mosrespektim i kërkesave për marrjen e masave parandaluese për krijimin e një sistemi të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave dhe me elemente për identifikimin e anomalive;
- njohuri jo të mjaftueshme dhe moszbatimimi i detyrimeve ligjore, si dhe akteve nënligjore për PPP/PFT;
- mungesë trajnimesh në lidhje me detyrimet ligjore si dhe aktet nënligjore për PPP/PFT;
- mungesë evidence për raste dyshimi për ngjashmëri emrash me listat e shpallura dhe listat e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) apo evidenca që ka kryer verifikime me listat e shpallura.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka kryer vlerësimin e ekspozimit të këtij rreziku për subjektet në kontekstin e analizave në distancë mbi bazën e raportimeve të kryera në fillim të vitit 2024 me të dhëna për vitin 2023. Ky vlerësim, siç e kemi përmendur edhe më parë, konsiston në integrimin e vlerësimit për sasinë e rrezikut dhe vlerësimin për cilësinë e administrimit të rrezikut, për të bërë kategorizimin e institucioneve, si dhe orientimin e fokusit mbikëqyrës në funksion të parimeve të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Vlerësimi u krye për 683 subjekte financiare (11 banka, 37 IFJB, 10 SHKK dhe 625 ZKV).



### 6.4.5.2 Transparenca dhe publikimi i informacionit

Transparenca dhe publikimi i informacionit, elemente këto që ndikojnë në shkallën e besueshmërisë së publikut ndaj sistemit financiar në vend, kanë vijuar të jenë në fokusin e Bankës së Shqipërisë edhe gjatë vitit 2023.

Janë analizuar detyrimet që kanë bankat për raportim në Bankën e Shqipërisë, në drejtim të zbatimit të kuadrit rregullativ për transparencën, dhe është evidentuar problematika e raportimit apo publikimit në mënyrë të plotë të kushteve të punës edhe në faqet e internetit të bankave.

Sjellja e bankave dhe masat e marra prej tyre në lidhje me transparencën me publikun dhe publikimin e informacionit financiar janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet analizave nga jashtë dhe mbikëqyrjes në vend.

Si rezultat i monitorimit dhe i masave të ndërmara nga Banka e Shqipërisë është rritur ndërgjegjësimi dhe angazhimi i sektorit bankar për çështjet e transparencës dhe të publikimit të informacionit. Megjithatë, ende evidentohen çështje për përmirësim të mëtejshëm në drejtim të:

- kuadrit rregullator të brendshëm (kryesisht në metodologjinë për llogaritjen e normave të interesit dhe komisioneve, njërive përgjegjëse të përfshira për publikimin e informacionit dhe raportimit në Bankën e Shqipërisë, në baza periodike, të normave të interesit për kreditë/ depozitat dhe komisionet për produktet dhe shërbimet bankare e financiare që ajo i ofron klientëve);
- informacionit parakontraktor (në drejtim të personalizimit të informacionit dhe përfshirje të disa prej elementeve të parashikuara në kuadrin rregullator);
- informacionit kontraktor (kontrata) të kredisë konsumatore, hipotekare, kartës së kreditit, depozitës, llogarisë rrjedhëse dhe llogarisë së kursimit në përputhje me kërkesat rregullatore;
- elementeve të caktuara në informacionin e publikuar në faqet e internetit;
- njohurive të stafit (në drejtim të funksionimit të llogarisë së pagesës, shërbimit të transferimit të llogarisë së pagesës dhe marrëdhënieve me klientët për monedhat e rralla (hapjes së llogarive në monedha të rralla dhe transaksioneve që do të kryhen nga këto llogari (transfertat), të cilat mbartin disa kosto të fshehura në këmbimet nga një monedhë në tjetrën).

Në IFJB dhe në SHKK, çështjet për të adresuar më së shumti lidhen me:

- politikat dhe procedurat (jo në përputhje të plotë me kërkesat rregullatore);
- informacionin parakontraktor (në drejtim të përfshirjes të disa prej elementeve parashikuar në kuadrin rregullator, vendosjen e të drejtës së konsumatorit për pajisjen me kopjen e projektkontratës së kredisë dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit, në rast ndryshimesh të kushteve);
- informacionin kontraktor (kontrata) të kredisë konsumatore, hipotekare,



kartës së kreditit, depozitës, llogarisë rrjedhëse dhe llogarisë së kursimit në përputhje me kërkesat rregullatore;

- elemente të caktuara në informacionin e publikuar në faqet e internetit;
- publikimin e informacionit (fletëpalosjet e publikuara në ambientet e punës nuk janë të përditësuara, informacioni i publikuar nuk është i plotë);
- llogaritjet e normave të interesit, NEIt, komisioneve dhe penalteteve (metoda e llogaritjes së këstit të kredisë shoqëruar me një shembull (ilustrues) nuk është reflektuar në kontratë, për NEI-n, nuk shfaqet vlera e saj në kontratë (në %) së bashku me të dhënat financiare për çdo element përbërës të saj, për kamatëvonesën, nuk është shoqëruar edhe me një shembull konkret (ilustrues) për llogaritjen e tyre, vlera e penaltetit të llogaritur në sistem nuk përputhet me vlerën e përftuar nga zbatimi i formulës së shprehur në kontratën e kredisë).


Përpos ekzaminimeve në vend, me qëllim vlerësimin e subjekteve për përputhshmërinë me kërkesat e akteve rregullative të Bankës së Shqipërisë, janë realizuar dhe analiza nga jashtë, lidhur me publikimin e raporteve financiare dhe kushteve të punës për produktet dhe shërbimet e ofruara të subjekteve të licencuara. Në kuadër të informimit të publikut është realizuar me periodicitet, publikimi i formularëve të transparencës për normat e interesit dhe komisionet për produktet dhe shërbimet e ofruara për publikun nga bankat dhe IFJB-të.

Gjatë vitit 2023, janë monitoruar kërkesat minimale të publikimit të raporteve financiare nga bankat dhe degët e bankave të huaja. Në përgjithësi, informacioni i publikuar nga bankat është në përputhje me kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë mbi publikimet.


Në kuadër të transparencës, angazhimi në inspektimet në vend ka pasur si qëllim vlerësimin e subjekteve për përputhshmërinë me kërkesat e akteve rregullative të Bankës së Shqipërisë.

#### 6.4.5.3 Trajtimi i ankesave

Trajtimi i ankesave nga klientët ka zënë një peshë të konsiderueshme në kuadrin e transparencës dhe mbrojtjes së klientëve të sektorit financiar. Në vitin 2023 u trajtuan një numër i konsiderueshëm (239) ankesash/kërkesash/letrash të ardhura nga individë, biznese, persona fizikë, media, përmbaues dhe institucione shtetërore.




Grafik 17. Numri i ankesave të trajtuara në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Peshë e ankesave sipas segmentimit të ankuesve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Siç shihet edhe në Grafikon 18, numrin më të madh të ankesave të trajtuara e zënë individët me 83,68% të tyre.


Siç vërehet nga Grafiku 19, peshën më të madhe e zë produkti i kredisë me 45,61%.

Grafik 19. Peshë e ankesave sipas segmentimit të produkteve të reklamuar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Peshë e ankesave sipas tipologjisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga Grafiku 20 vërehet se peshën më të madhe e zë tipologjia “Të tjera” me 75,73%. Në këtë tipologji kryesisht përfshihen kërkesat për Bankën e Shqipërisë në lidhje me ndërhyrjen e saj për lehtësimin e kushteve të kredisë dhe kërkesa të ndryshme për informacion, ndërkohë që pjesën tjetër e zënë ankesat/kërkesat/letrat që lidhen me kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, mbi nivelin e komisioneve dhe normave të interesit të aplikuara nga bankat dhe institucionet financiare jobanka për produktet dhe shërbimet e aplikuara, etj.





## 6.4.6 PËRFITUESHMËRIA

### 6.4.6.1 Rezultati neto dhe struktura e tij

Rezultati financiar i vitit 2023 është pozitiv, me një vlerë prej rreth 32.5 miliardë lekësh, ose 11.7 miliardë lekë (56%) më i lartë se ai i vitit 2022.

Përgjatë vitit 2023, evidentohet një rritje e rezultatit financiar neto në të gjithë tremujorët. Rritja më e madhe evidentohet në tremujorin e dytë me një rritje prej 7.9 mld lekësh ose 116%, pasuar nga rritja në tremujorin e tretë me 8 mld lekë ose 54%, si dhe rritja në tremujorin e katërt me 9.7 mld lekë ose 42.95%. Ndikimin më të madh në rezultatit financiar të tremujorit të parë e ka dhënë rritja e rezultatit neto nga interesat me 110%, ndikuar nga rritja e të ardhurave nga interesat e letrave me vlerë me 115%, si dhe nga interesat nga portofoli i kredisë me 103%.

### 6.4.6.2 Treguesit e përfitueshmërisë

Ecuria e treguesve kryesorë të përfitueshmërisë, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali aksioner mesatar (RoAE) shfaqet në rritje krahasuar me vitin 2022. Vlerat, në fund të vitit 2023, shfaqen në 1.7% për RoAA dhe 17.3% për RoAE, ndërsa në fund të vitit 2022 këta tregues ishin përkatësisht 1.2% dhe 11.8%.

Tabelë 15. Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë (në përqindje; kumulative)

Treguesit	Dhjetor 2023	Dhjetor 2022	Dhjetor 2021	Dhjetor 2020
RoAA	1.7	1.2	1.3	1.1
RoAE	17.3	11.8	12.6	10.4


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabela 16 shfaq përfitueshmërinë e sistemit bankar nga veprimtaria kryesore, si dhe dinamikën e ekuilibrit ndërmjet mbledhjes së burimeve për të cilat paguhet interes dhe investimit në aktive që gjenerojnë të ardhura. Dinamika e tyre gjatë vitit 2023 tregon për një rritje të eficiencës së përdorimit të burimeve me 0.7 pikë përqindje, e ndikuar nga rritja më e lartë e të ardhurave nga interesat në krahasim me rritjen e shpenzimeve për interesa.

Tabelë 16. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore (në përqindje; kumulative)

	Dhjetor 2023	Dhjetor 2022	Dhjetor 2021	Dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesat/aktive mesatare që sjellin të ardhura(1)	4.40	3.5	3.3	3.4
Shpenzime për interesa/aktive mesatare që sjellin të ardhura(2)	0.90	0.7	0.5	0.5
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) - (2)]	3.5	2.8	2.8	2.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Në fund të vitit 2023, raporti i aktiveve mesatare që sjellin të ardhura ndaj aktiveve mesatare u rrit me 1.07 pikë përqindjeje (nga 84.04% në 85.11%) krahasuar me fundin e vitit të kaluar, ndikuar nga rritja më e madhe e aktiveve mesatare që sjellin të ardhura përkundrejt rritjes së aktiveve mesatare. Për sa i përket raportit “pasive mesatare që shkaktojnë shpenzime ndaj aktiveve mesatare”, rezultoi të jetë ulur me 5.07 pikë përqindje (nga 92.17% në 87.10%) krahasuar me fundin e vitit të kaluar, ndikuar nga rritja më e madhe e aktiveve mesatare përkundrejt rritjes së pasiveve mesatare që shkaktojnë shpenzime.

Tabelë 17. Treguesit mesatarë të përfitueshmërisë (në milionë lekë)

Treguesit	Dhjetor 2023	Qershor 2023	Dhjetor 2022	Qershor 2022
Aktivet mesatare që sjellin të ardhura (1)	1,610,642.2	1,591,349.5	1,471,651.8	1,498,931.5
Pasivet mesatare që shkaktojnë shpenzime (2)	1,648,458.7	1,649,708.7	1,614,031.2	1,658,850.3
Aktivet mesatare (3)	1,892,506.4	1,874,989.9	1,751,114.7	1,782,743.5
(1) / (3)	85.11%	84.87%	84.04%	84.08%
(2) / (3)	87.10%	87.98%	92.17%	93.05%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i efikasitetit të përdorimit të burimeve nga sistemi është rritur me 18.14 p.p në krahasim me vitin paraardhës, në kushtet kur të ardhurat operacionale janë rritur me ritme më të larta se shpenzimet operacionale, me 19.5 milionë lekë ose 29.45%, ndërkohë që shpenzimet operacionale janë rritur me 7 milionë lekë ose 17.25%.

Tabelë 18. Ecuria e treguesit të efikasitetit (në milionë lekë)

Treguesit	Dhjetor 2023	Dhjetor 2022	Dhjetor 2021	Dhjetor 2020
Rezultati neto nga interesat (1)	66,287.4	48,707.8	46,762.8	43,678.1
Shpenzimet e veprimtarisë (2)	40,928.1	33,866.5	32,192.7	29,759.2
Efikasiteti (1) / (2)	161.96%	143.82%	145.26%	146.77%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 6.4.7 MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT


### 6.4.7.1 Kapitali aksioner

Në fund të vitit 2023, kapitali aksioner i sistemit bankar arrin nivelin prej 195.39 miliardë lekësh, me një rritje vjetore prej 12.01 miliardë lekësh ose 6.55% përkundrejt rritjes në nivel më të ulët prej 8.05 miliardë lekësh ose 4.6% gjatë vitit 2022.



Gjatë vitit 2023, kapitali aksioner ka shfaqur një rritje gjatë tremujorëve të fundit ndërmjet normave 2.2% dhe 3.2%, përveç tremujorit të parë ku pati një rënie të kapitalit aksioner me 0.5%.

Komponentët me ndikim më të madh material në rritjen e kapitalit aksioner janë rritja e fitimeve të periudhave raportuese me 11.7 mld lekë ose 56%, si dhe rritja e fitimeve të pashpërndara me 1.9 mld lekë ose 5.4%.




Tabelë 19. Struktura e kapitalit aksioner të sistemit dhe ecuria e komponentëve të tij

Treguesit	Dhjetor 2023		Dhjetor 2022		Dhjetor 2021		Dhjetor 2020	
	mld lek	%	mld lek	%	mld lek	%	mld lek	%
Kapitali aksioner	195,389.4	100.0	183,384.3	100.0	175,331.2	100.0	163,966.7	100.0
Kapitali i paguar	97,840.3	50.1	94,421.6	51.5	102,363.0	58.4	101,859.3	74.8
Primet e aksioneve	7,152.7	3.7	7,152.7	3.9	7,130.6	4.1	7,084.1	4.4
Rezervat	35,626.4	18.2	34,140.2	18.6	26,035.0	14.8	23,537.8	12.4
Diferencë rivlerësimi	(14,888.9)	(7.6)	(8,386.7)	(4.6)	(8,037.6)	(4.6)	(9,005.2)	(4.7)
Fitim/humbje e pashpërndarë	37,176.4	19.0	35,267.6	19.2	26,662.0	15.2	23,994.0	0.8
Fitim/humbje e periudhës	32,482.5	16.6	20,788.8	11.3	21,178.2	12.1	16,496.7	12.5


Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 6.4.7.2 Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Përkundrejt minimumit rregullator të kërkuar prej 12%<sup>15</sup>, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, si tregues thelbësor mbikëqyrës, në fund të vitit 2023, raportohet në nivelin 19.4%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ky tregues shfaqet me një rritje prej 0.6 pikë përqindjeje.



<sup>15</sup> Për disa banka, ky nivel është kërkuar më i lartë se minimumi rregullator.




#### **6.4.7.2.1 Kapitali rregullator**

Kapitali rregullator i sistemit bankar evidentohet në nivelin 187.160 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2022, kapitali rregullator shfaq një rritje prej 7.5 miliardë lekësh ose 4.19%.

Kapitali bazë i sistemit bankar përbën komponentin kryesor të kapitalit rregullator të sistemit me një peshë prej rreth 91.27%, në rënie me 1.79 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar, por gjithsesi mbetet në nivele që tregojnë për një kapital rregullator cilësisht të qëndrueshëm.

#### **6.4.7.2.2 Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik**

Totali i aktiveve dhe i zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik është rritur në krahasim me atë të vitit të kaluar me 10.3 milionë lekë ose 1.08%. Elementi që ka peshën më të madhe në totalin e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik janë aktivet për të cilat kërkohet kapital për rrezikun e kredisë me 85.87%, e ndjekur nga ato për të cilat kërkohet kapital për rrezikun operacional me 12.7% dhe aktivet për të cilat kërkohet kapital për rrezikun e tregut me 1.46%.



## 6.5 INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA DHE SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT

### 6.5.1 SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA


#### 6.5.1.1 Të përgjithshme

Në fund të vitit 2023, sistemi financiar numëron 39 subjekte financiare jobanka. Gjatë këtij viti janë licencuar dy subjekte te reja, "BKT Pay" si institucion i parasë elektronike dhe "New Collection", si institucion i blerjes dhe trajtimit të kredive me probleme. Ndërkohë, me kërkesë të subjektit, është kryer revokimi i licencës për institucionin e pagesave "Kastrati" shpk. Informacioni mbi veprimtarinë e subjekteve paraqitet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 20.

Tabelë 20. Veprimtarinë e lejuara për subjektet financiare jobanka



Nr.	Institucione Financiare Jobanka	Para elektronike	Shërbime të pagesave dhe transferimit të parave	Veprimtari me Rrezik Kredie						Këmbim valutë	
				Kredidhënie	Mikrokredi	Qira Financiare	Factoring	Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime	Për ofrimin e garancive dhe marrjen e anqazhimeve	Blerje Kredi me probleme	Shërbime të këmbimit valutë
1	Agro & Social Fund (VF)				✓						
2	Kredit Partner				✓						
3	Agrokredit - ish FAF			✓				✓	✓		
4	Ak-Invest		✓	✓			✓	✓	✓	✓	✓
5	Albania Leasing					✓					
6	Albanian Financial Institution			✓		✓	✓	✓	✓		
7	Crimson Finance Fund Albania (CFFA)			✓		✓	✓	✓			
8	Easypay*	✓	✓							✓	✓
9	FIN – AL			✓		✓					
10	Fondi Besa			✓				✓	✓		
11	Iutecredit Albania				✓						
12	Kredo Financë				✓						
13	Landeslease					✓					
14	MIA Finance				✓						
15	Micro Credit Albania			✓				✓			
16	Credital				✓						
17	Virtus Lending					✓					
18	M-Pay		✓								
19	NOA		✓	✓					✓		
20	FAB INVEST shpk			✓			✓	✓		✓	✓
21	Platinum Investment										✓
22	Porshe Leasing					✓					
23	Posta Shqiptare*	✓	✓							✓	
24	Raea Financial Services		✓							✓	✓
25	Raiffeisen Leasing					✓					
26	Tirana Capital Trade						✓				
27	Tirana Factoring & Lease					✓	✓			✓	
28	Tranzit			✓		✓	✓	✓			
29	Unioni Financiar i Tiranës*	✓	✓							✓	✓
30	Paysera Albania	✓									
31	Antigone Financial Enterprise					✓					
32	eReja shpk	✓									
33	RPay	✓									
34	Soft Solution	✓									
35	Lendal Sh.p.k.				✓						
36	Rubicon sha	✓									
37	Iutepay	✓									
38	BKT pay	✓									
39	New collection									✓	

Burimi: Banka e Shqipërisë.



### 6.5.1.2 Aktiviteti i IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit (të gjitha format e kredidhënies, mikrokredi, qira financiare, faktoring, blerje kredi me probleme)

Totali i aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit gjatë vitit 2023 ka njohur rritje me rreth 7 mld lekë ose 12%. Në dhjetor 2023, totali i aktiveve të këtyre subjekteve arrin në 65 miliardë lekë dhe përbën 3.3% të totalit të aktiveve të sistemit bankar.



Subjektet me peshën më të lartë në totalin e aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit janë: "Fondi Besa" (28%), "NOA" (21%) dhe "Iutecredit Albania" (11%).


Tabelë 21. Totali i aktiveve të IFJB-ve

Treguesi/miliardë lekë	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Totali i aktiveve të IFJB-ve	55.57	58.00	64.65

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në strukturën e aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit, peshën kryesore e mban portofoli i kredisë me 73%. Pjesa tjetër është e shpërndarë në aktive likuide (14%), të tjera të arkëtueshme (9%) dhe mjete të tjera (përfshirë mjetet e qëndrueshme) (4%).

Burimet parësore të financimit për IFJB-të që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit janë huamarrjet (66% e pasivit) dhe kapitali i tyre (28%). Huamarrja përmes emetimit të titujve zë vetëm 1%. Përsa i përket origjinës së huamarrjeve, balanca anon lehtë nga jorezidentët me 52%.



### 6.5.1.2.1 Zhvillimet në tepricën e portofolit të kredisë dhe vëllimet e veprimtarisë

Në fund të vitit 2023, portofoli i kredisë bruto për IFJB-të arrin në 53.6 miliardë lekë, duke njohur një rritje prej 6.23 miliardë lekësh (ose 13%) krahasuar me vitin paraardhës. Portofoli i kredisë bruto të IFJB-ve arrin në 7.25% të totalit të kredisë së sistemit bankar, duke regjistruar një rritje prej 1 p.p. krahasuar me vitin paraardhës.

Tabelë 22. Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e SFJB-ve

Treguesi/miliardë lekë	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (bruto)	42.1	47.38	53.61
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (neto)	37.4	42.02	47.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë së IFJB-ve mbahet nga subjektet e kredidhënies dhe mikrokredisë (78%). Më pas renditet portofoli i qirasë financiare (21%), ndërsa pesha e portofolit faktoring mbetet më pak se 1%.

Aktiviteti me rritjen më të lartë edhe gjatë vitit 2023 ka qenë mikrokredia, me 5.2 miliardë lekë. Por duhet theksuar se kjo rritje është më tepër rezultat i ngjarjeve që ndodhin vetëm një herë. Konkretisht, gjatë vitit 2023, subjekti "NOA", një nga subjektet me peshë të rëndësishme në treg, për herë të parë ka vendosur të raportojë një pjesë të portofolit të saj si mikrokredi (më parë i gjithë portofoli raportohet në segmentin e kredisë). Efekti i këtij riklasifikimi është 2.2 miliardë lekë (pra kjo shumë i zbritet portofolit të kredisë dhe i shtohet atij të mikrokredisë).

Gjatë këtij viti, edhe subjekti "Micro Credit Albania" paraqet një rritje të ndjeshme të portofolit të mikrokredisë (0.53 miliardë lekë). Vitin e kaluar kjo shumë qëndronte në zërin "Të tjera të arkëtueshme", si kredi me probleme të blera, por të patrajtuara nga subjekti. Pas masës së pezullimit të veprimtarisë që Banka e Shqipërisë aplikoi ndaj këtij subjekti gjatë vitit 2023, ai ka trajtuar një numër të lartë të kredive, duke i klasifikuar ato në klasat përkatëse të portofolit të mikrokredisë.

Në mënyrë të ngjashme, edhe subjekti "Final", gjatë vitit 2023, ka transferuar një pjesë të kredive me probleme që kishte blerë nga subjektet e tjera (0.43 miliardë lekë), nga zëri "Të tjera të arkëtueshme" në klasat përkatëse të portofolit të mikrokredisë.

Ndërsa subjektet e mikrokredisë që në mënyrë konstante shfaqin rritjen më të lartë të aktivitetit janë "IuteCredit" dhe "Kredo Finance".



Tabelë 23. Ecuria e portofolit të kredisë bruto sipas veprimtarive të IFJB-ve

Veprimtaritë financiare (në miliardë lekë)	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Kredihënie	16.6	18.4	18.8
Mikrokredi	15.4	18.0	23.2
Qira financiare	9.6	10.4	11.2
Faktoring	0.5	0.4	0.4
Portofoli bruto	42.1	47.4	53.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2023, portofoli i financimeve të subjekteve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit është i balancuar në raportin 50%:50% midis bizneseve dhe individëve.

Sektorët e ekonomisë më të financuar nga subjektet jobanka gjatë vitit 2023 kanë qenë "Aktivitete të tjera shërbimi" (25%) "Tregtia, riparimi i automjeteve" (16%) dhe "Ndërtimi" (10%).

Portofoli i IFJB-ve mbetet i orientuar drejt financimeve në monedhën vendase (68.6%) dhe me afat të mesëm maturimi (71.6%).

**Portofoli i qirasë financiare**, sipas produkteve, dominohet nga financimet për mjete transporti personale (42%) dhe mjete transporti pune (29%). Krahasuar me dhjetorin 2022, portofoli shënon një rritje me rreth 76 mln lekë, lokalizuar në produktin "Mjete transporti personale".


Tabelë 24. Portofoli i qirasë financiare sipas objektit të financuar

Qira Financiare (miliardë lekë)	Paisje e re	Paisje e përdorur	Dhjetor 2022	Paisje e re	Paisje e përdorur	Dhjetor 2023
Mjete transporti personale	2.10	2.07	4.17	2.42	2.22	4.64
Mjete transporti pune	2.05	1.17	3.22	2.11	1.11	3.22
Pajisje pune/linja prodhim	0.73	0.31	1.04	0.56	0.24	0.80
Pasuri të patundshme	0.09	0.01	0.10	0.03	0.1	0.13
Të tjera	1.84	0.04	1.88	2.32	0.06	2.38
Totali	6.82	3.59	10.41	7.43	3.73	11.17

Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Portofoli faktoring**, në fund të vitit 2023, paraqitet me një tepricë prej 0.43 miliardë lekësh, duke njohur një rënie prej 0.06 miliardë lekësh krahasuar me vitin paraardhës. Qarkullimi vjetor i portofolit faktoring është ulur me 0.03 miliardë lekë në krahasim me vitin 2022, shoqëruar edhe nga ulja e numrit të faturave të qarkulluara.

Aktiviteti i faktoringut është realizuar në masën 87% në tregun vendas dhe kryesisht për financime me garanci (92.4%).





Tabelë 25. Volumet vjetore dhe teprica e portofolit faktoring

Faktoring	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Qarkullimi			
Nr. faturash	1,930	2,170	1,476
Vlerë (miliardë lekë)	1.39	1.4	1.4
Teprica e portofolit (miliardë lekë)	0.48	0.49	0.43

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 6.5.1.2.2 Cilësia e portofolit të kredisë

Në fund të vitit 2023, **treguesi i kredive me probleme** për subjektet financiare është rritur me 0.7 pikë përqindje. Rritja e totalit të kredive me probleme (rreth 85% e saj) është ndikuar kryesisht nga veprimet e subjekteve "Final" dhe "Micro Credit Albania", të cilat gjatë vitit 2023 kanë trajtuar volume të konsiderueshme të kredive me probleme, të blera nga bankat dhe institucionet e tjera (më tepër detaje gjenden në seksionin 6.5.1.2.1 Zhvillimet në tepricën e portofolit të kredisë dhe vëllimet e veprimtarisë).

Tabelë 26. Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë

Treguesit	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Kredi me probleme/ Teprica e kredisë (bruto)	13.60	13.20	13.90
Kredi me probleme/ Teprica e kredisë (neto)	3.96	3.54	3.39


Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 6.5.1.2.3 Rezultati financiar

Gjatë vitit 2023, IFJB-të që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit kanë gjeneruar një rezultat pozitiv neto prej 4.96 miliardë lekësh<sup>16</sup>. Krahasuar me vitin paraardhës vërehet një rritje prej 2.3 mld lekësh, pjesa më e madhe e të cilës i takon dividendit nga aksionet që merr subjekti "Tranzit". Ky i fundit edhe këtë vit është subjekti me kontributin më të lartë në fitimin e realizuar, ndërsa pas tij renditen "Kredo Finance" dhe "luteCredit".

Kthimi mesatar nga aktivet për IFJB-të që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit arrin në 7.7% (kundrejt 4.8% në vitin 2022), ndërsa kthimi mesatar nga kapitali arrin në 37.4% (kundrejt 17.9% në vitin 2022).

<sup>16</sup> Për vitin 2022, rezultati neto i IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit ishte 2.66 miliardë lekë.



## 6.5.2 INSTITUCIONET E PAGESAVE DHE TË PARASË ELEKTRONIKE

### 6.5.2.1 Numri i subjekteve

Për fundin e vitit 2023, numërohen 5 subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e pagesave dhe 10 subjekte që ushtrojnë aktivitetin e parasë elektronike (një subjekt i parasë elektronike është licencuar në vitin 2023).

### 6.5.2.2 Ecuria e aktiveve

Totali i aktiveve të subjekteve të parasë elektronike, për vitin 2023, ka njohur një rritje prej 185 milionë lekësh. Krahas rritjes së aktivitetit të subjekteve, ndikuar nga licencimi i një subjekti të ri në këtë periudhë, por edhe nga rritja e aktiveve të subjekteve Paysera dhe Velox.

Tabelë 27. Totali i aktiveve të subjekteve IPE

Volumi (mln lekë)	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Totali i aktiveve	11,666.19	14,170.97	14,356.27

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 6.5.2.3 Aktiviteti i transfertave dhe pagesave

Shërbimet e pagesave dhe transfertave për vitin 2023 kanë njohur rënie si në numër, edhe në vlerë, ndërsa pagesat në nisje, kanë një ecuri pozitive për këtë periudhë. Ecuria e tyre paraqitet në Tabelën 28.

Tabelë 28. Ecuria e shërbimit të pagesave & transfertave (nuk përfshihet paraja elektronike)


	Viti 2022*		Viti 2023	
	Nr.	Volumi (miliardë lekë)	Nr.	Volumi (miliardë lekë)
Transfertat në nisje	1,042,733	28.79	756,329	19.65
Transferta në mbërritje	2,467,268	112.65	2,741,213	108.16
<b>Transferta në Total</b>	<b>3,510,001</b>	<b>141.45</b>	<b>3,497,542</b>	<b>127.81</b>
Pagesa në nisje	10,519,592	42.19	12,744,389	47.87

Burimi: Banka e Shqipërisë.

\* Të dhënat janë rishikuar pas korigjimeve të raportuara nga subjektet.

Ecuria e transfertave (rënia e volumeve) është ndikuar nga zhvillimi i shpejtë i aktivitetit të parasë elektronike në vitin 2023, si një shërbim që ofron më tepër lehtësi për klientët, duke qenë se mund të aksesohet dhe të përdoret në distancë, përmes pajisjeve personale (kompjuter, celular, etj.).

Për vitin 2023, vlera e pagesave të kryera me para elektronike arrin në 91.6 miliardë lekë, me një rritje rreth 100% krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa numri i tyre arrin mbi 14 milionë lekë, me një rritje rreth 38%. Numri total i llogarive të parasë elektronike në fund të vitit 2023 është 152,862 llogari.



### 6.5.2.4 Rezultati financiar

Tabelë 29. Volumi i të ardhurave

Volumi (mln lekë)	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Rezultati neto	830.62	699.20	1,290.94

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezultati neto i institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike shfaq luhatje për shkak të përfshirjes së subjekteve të reja, të cilat në vitet e para të aktivitetit operojnë me humbje. Edhe tek subjektet më të konsoliduara në treg, rezultati shfaq luhatje për shkak të kostove të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e teknologjisë së përdorur gjatë aktivitetit.

## 6.5.3 UNIONET FINANCIARE DHE SHOQËRITË E KURSIM KREDITIT

### 6.5.3.1 Numri i shoqërive

Numri i shoqërive të kursim-kreditit (SHKK) dhe unioneve të tyre nuk paraqet ndryshime gjatë vitit 2023. Në këtë grup subjektësh bëjnë pjesë 16 SHKK dhe 1 union, nga të cilat vetëm 9 SHKK janë përfshirë në skemën e sigurimit të depozitave. Unioni Shqiptar Kursim-Kredi (USHKK) është unioni i vetëm që vijon të jetë i licencuar, por ai nuk kryen veprimtari.

### 6.5.3.2 Ecuria e aktiveve

Totali i aktiveve<sup>17</sup> të grupit të SHKK-ve, në fund të vitit 2023, arrin në 15.11 miliardë lekë, me një rritje prej 890 milionë lekësh ose 6% krahasuar me fundin e vitit 2022. Ndikimi më i madh në këtë rezultat vjen kryesisht nga rritja e aktiveve të SHKK-ve të mëdha (Fed Invest, Alb-Progres dhe Alb Credit).

Struktura e aktivitetit të grupit të SHKK-ve vijon të jetë e orientuar drejt huadhënies ndaj anëtarëve (76%) dhe mjeteve likuide (19%). Peshën më të madhe në totalin e aktiveve të SHKK-ve e zënë "Fed Invest" me 52%, "Alb-Progress" me 15%, "Alb Credit" me 11% dhe "UniFin" me 9%.


Totali i aktiveve të SHKK-ve është vetëm 0.77% e totalit të aktiveve të sistemit bankar.

Tabelë 30. Ecuria e aktiveve (në miliardë lekë)

Totali i aktiveve/miliardë lekë	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
SHKK	13.12	14.22	15.11

Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>17</sup> Në llogaritje janë përfshirë edhe ato SHKK që nuk janë pjesë e skemës së sigurimit të depozitave, por që raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë.



### 6.5.3.3 Zhvillimet në tepricën e portofolit të kredisë

Në dhjetor 2023, portofoli i kredisë bruto për grupin e SHKK-ve arrin në 12 miliardë lekë, me një rritje prej 1.3 miliardë ose 12%, krahasuar me vitin e mëparshëm. Kontributin më të lartë në këtë rritje e kanë dhënë SHKK-të "Fed Invest", "UniFin" dhe "Alb Progres".

Portofoli i kredisë bruto të SHKK-ve përbën vetëm 1.6% të portofolit të kredive të sistemit bankar.

Tabelë 31. Ecuria e portofolit të kredisë bruto dhe neto për SHKK-të

Treguesit për SHKK-të (në miliardë lekë)	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Kredia bruto	9.34	10.70	11.97
Kredia neto	8.93	10.28	11.51

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në dhjetor 2023, treguesi i kredive me probleme për SHKK-të paraqitet në nivelin 4.6%, me një rënie të lehtë prej 0.03 pikë përqindjeje krahasuar me vitin paraardhës. Ky përmirësim ka ardhur si pasojë e rritjes së totalit të kredive (12%), me ritme më të larta se rritja e kredive me probleme (11%).

### 6.5.3.4 Rezultati financiar


Gjatë vitit 2023, shoqëritë e kursim-kreditit kanë gjeneruar një rezultat financiar pozitiv, i cili arrin në 183.5 mln lekë. Ky rezultat mbetet pothuajse në të njëjtin nivel si në vitin paraardhës (rënie e lehtë me rreth 0.5 milionë lekë). Gjatë periudhës, vërehet një rritje e shpenzimeve për provigjione dhe atyre të vëprimitarisë, të cilat kanë ndikuar në rënien e lehtë të fitimit.

Për vitin 2023, kthimi mesatar nga aktivet për SHKK-të arrin në 1.21% (kundrejt 1.29% në 2022), ndërsa kthimi mesatar nga kapitali arrin në 9.45% (kundrejt 10.47% në 2022).

## 6.6 REGJISTRI I KREDIVE

Edhe gjatë vitit 2023, Regjistri i Kredive ka vijuar të sigurojë mirëmbajtjen dhe saktësinë e raportimit të të dhënave për subjektet pjesëmarrëse në të, si dhe asistencën e nevojshme për përdoruesit e autorizuar të subjekteve, lidhur me funksionimin pa ndërprerje të raportimit të të dhënave dhe përdorimit të Regjistrit të Kredive.

Volumi i raporteve të përpunuara ka ardhur në rritje. Gjatë vitit 2023, numri i kërtimeve të realizuara nga raportuesit e të dhënave regjistron një rritje me 6%, krahasuar me një vit më parë. Rritja e numrit të kërtimeve, ka dhënë impakt



pozitiv në gjenerimin e të ardhurave nga Regjistri i Kredive (i cili nuk ka si qëllim fitimin). Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat nga sistemi janë rritur me 6%.


Tabelë 32. Institucionet e licencuara që raportojnë të dhëna në Regjistrin e Kredive

RAPORTUES TË DHËNASH			
1	Banka e Shqipërisë		
	Banka		Institucione Financiare jo banka
1	Banka Raiffeisen	1	Agro & Social Fund shpk
2	Banka OTP	2	AGRO Partner Sh.P.K
3	Banka Amerikane e Investimeve	3	Agrokredit sha
4	Banka Credins	4	Ak Invest
5	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	5	Albania Leasing Sh.A.
6	Banka e parë e Investimeve	6	Albanian Financial Institution
7	Banka Intesa sanpaolo	7	Antigone Financial Enterprise shpk
8	Banka Kombëtare Tregtare	8	Capital Invest (Mia Finance Sha)
